

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6117
E premte, 18 shtator 2020
çmimi 0.40 €

Kuvendi sërish dështon ta votojë Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike

FAQE 9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SABRI KIÇMARI | FAQE 4-5

KOSOVA KA BËRË KONCESIONE TË PAPRITURA NË UASHINGTON

OPINION

UJMANI ËSHTË TOKA JONË F. 11

Shkruan:
Albin KURTI



AKTUALE



TOMË GASHI: DOSJET
E DËRGUARA NË ZYRAT E
OVLUÇK-së JANË TË SPECIALES F. 5

TRE TË VDEKUR, 43 TË
INFEKTUAR DHE 239 TË SHËRUAR
NGA COVIDI NË KOSOVË F. 7

VOTA E DODIKUT PAMUNDËSON
NJOHJEN E KOSOVËS NGA
BOSNJE DHE HERCEGOVINA F. 2

EKONOMI

PRODHUESIT KËRKOJNË
GARANTIM TË VEÇANTË KREDITOR
PËR SEKTORIN E TYRE F. 8

BIZNESET QË NGA FILLIMI I
PANDEMISË COVID-19 KANË
HUMBUR 1 MILIARD EURO F. 9

KULTURË

MINISTRJA DUMOSHI VIZITON
DRESNIKUN, VENDIN E
RËNDËSISHËM ARKEOLOGJIK F. 10

SPORT

KRASNIQI EMËROHET DREJTOR
TEKNIK NË FBK F. 16



Dokumenti i
Uashingtonit
është akt
joformal dhe
juridikisht
jodetyrues

Njohësi i marrëdhënieve ndërkombëtare, Sabri Kiçmari, ka kritikuar marrëveshjen në Uashington të arritur më 4 shtator. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka

thënë se me këtë dokument Kosova ka bërë koncesione të papritura. Ish-ambasadori i Kosovës në Austri ka thënë se dokumenti i nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë nga Kosova dhe

Serbia nuk është marrëveshje as bilaterale, as trilaterale e as ndërkombëtare. Sipas tij, me këtë rast kemi të bëjmë me një akt joformal dhe juridikisht jodetyrues

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI KA RAPORTUAR NË
KUVEND PËR PROCESIN E DIALOGUT ME SERBINË

OPOZITA KRITIKON HOTIN PËR DIALOGUN ME SERBINË



Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës kanë kritikuar kryeministrin Avdullah Hoti për lëshimet e bëra në marrëveshjen me Serbinë të arritur në Uashington. Deputetët e LV-së kanë vlerësuar se me këtë marrëveshje ka fituar Serbia dhe jo Kosova, kurse ata të PDK-së kanë deklaruar se qeveria aktuale po tenton ta hapë pakon e Ahtisarit në procesin e Brukselit. Kryeministri Hoti i ka mohuar këto pretendime, duke thënë se në Bruksel do të bisedohet vetëm për njohje reciproke | FAQE 3



FAQE 2

KOSOVA DHE SERBIA, ME
QËNDRIME TË KUNDËRTA
PËR PRETENDIMET
FINANCIARE NË BRUKSEL

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kosova dhe Serbia, me qëndrime të kundërta për pretendimet financiare në Bruksel

Koordinatori shtetëror i Kosovës për dialog me Serbinë, Skender Hyseni, ka bërë me dije të enjten se palët kanë qëndrime shumë të kundërta për temën e pretendimeve financiare. Pas takimit me delegacionin serb në Bruksel, Hyseni ka theksuar se çështjet e suksesionit duhet të bëhen në pajtim me të drejtën ndërkombëtare me praktikën e suksesionit që kanë ndodhur mes entiteteve të ish-Jugosllavisë, tash shtete të pavarura



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Koordinator shtetëror i Kosovës për dialog me Serbinë, Skender Hyseni, ka thënë në përfundim të bisedimeve mes delegacioneve në Bruksel, se palët kanë qëndrime shumë të kundërta për temën e pretendimeve financiare. "Ne shohim që çështjet e suksesionit duhet të bëhen në pajtim me të drejtën ndërkombëtare me praktikën e suksesionit që kanë ndodhur mes entiteteve të ish-Jugosllavisë, tash shtete të pavarura. Ky është qëndrimi i Kosovës. Në këtë patjetër që përfshihet edhe borxhi i jashtëm. Edhe këtu Kosova ka qëndrim parimor që është në pajtim të ngushtë me të drejtën ndërkombëtare. Te borxhi i jashtëm ne do të insistojmë të aplikohet parimi i përfituesit të fundit", ka thënë Hyseni. Edhe i dërguari i posaçëm i BE-së për dialog, Miroslav Lajčak, i cili ndërmjetësoi bisedimet e së enjtes në Bruksel, tha përmes një postimi në rrjetin social "Twitter", se diskutimet mbi pretendimet e ndërsjella financiare dhe pronën kanë konfirmuar ndjeshmërinë e

kësaj çështjeje.

Ai ka thënë se diskutimet do të vazhdojnë, mirëpo pa dhënë detaje se kur do të jetë data tjetër e takimit. Kryenegociatori Skender Hyseni konfirmoi se në këtë takim nuk është diskutuar çështja e asociacionit të komunave serbe, edhe pse, sipas tij, pala serbe ka bërë përpjekje ta hapë këtë temë.

Para takimit, zëdhënësi i Bashkimit Evropian për çështje të jashtme, Peter Stano, ka thënë se tema lidhur me "aranzhimet për komunitetet joshumicë" do të jetë në rend dite në ditët në vijim, pa dhënë detaje të tjera. Prapa termit "aranzhimet për komunitetet joshumicë" qëndron çështja e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Ai ka rikujtuar se ekziston marrëveshja për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe dhe se pala e Kosovës "duhet të vijë me një propozim për zbatimin e marrëveshjes".

I pyetur se çka qëndron prapa termit "komunitetet joshumicë në Kosovë", dhe se a po bisedohet edhe për komunitetet e tjera joshumicë, e jo vetëm për komunitetin serb, ky zëdhënësi i BE-së ka thënë se edhe

terminologjia është diçka për të cilën janë pajtuar palët.

Por, Hyseni tha se kjo deklaratë është e nxituar dhe se "nuk ka pajtim që të bisedohet për asociacionin dhe as për datat kur do të bisedohet". Ai tha se Kosova nuk do ta lejojë përdorimin e terminologjisë "bashkësia e komunave joshumicë" pasi, sipas tij, komunitete joshumicë janë edhe boshnjakët, turqit etj. "Këtë lojë me terminologji ne nuk do ta lejojmë", ka thënë Hyseni.

Dialogu në mes të palëve në Bruksel është ripërtërirë më 16 korrik dhe ai po ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, janë takuar për herë të dytë më 7 shtator. Me këtë rast, sipas deklaratave të të dyja palëve, janë hapur temat për

asociacionin e komunave me shumicë serbe, për pretendimet e përbashkëta financiare dhe pronësore, ndërkaq janë harmonizuar qëndrimet lidhur me çështjen e të pagjeturve, personave të zhvendosur si dhe për bashkëpunimin ekonomik. Temat që ata përcaktojnë diskutohen më tej nga ekipet e ekspertëve të të dyja vendeve. Javën e kaluar, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, duke folur në një debat në Komitetin për Punë të Jashtme në Parlamentin Evropian, tha se Kosova do ta respektojë marrëveshjen për asociacionin e komunave me shumicë serbe të vitit 2015. Pas kthimit në Prishtinë, ai tha se "zbatimi i marrëveshjes do të bëhet në përputhje me secilën shkronjë të Kushtetutës".

Krijimi i asociacionit të

komunave me shumicë serbe është paraparë me marrëveshjen e parë të Brukselit të vitit 2013, të arritur në dialogun Kosovë - Serbi. Më 2015 të dyja vendet, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, kishin arritur një marrëveshje shtesë për themelimin e këtij asociacioni, porse Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur që parimet për asociacionin nuk janë në përputhje me Kushtetutën. Megjithatë, Kushtetuesja përcakton se parimet mund të harmonizohen me akt ligjor të Qeverisë së Kosovës.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë më 16 shtator se "hapja e temave për të drejtat e komuniteteve dhe për asociacionin e komunave serbe në dialogun e Brukselit është gabim i madh dhe shumë i rrezikshëm i Qeverisë së Kosovës".

Vota e Dodikut pamundëson njohjen e Kosovës nga Bosnje dhe Hercegovina

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Anëtari serb i presidencës trepalëshe të Bosnje dhe Hercegovinës, Millorad Dodik, ka votuar kundër njohjes së Kosovës në mbledhjen e jashtëzakonshme të presidencës të mbajtur të enjten.

Anëtari kroat i presidencës, Zelko Komshiq, i cili edhe e ka bërë propozimin për shqyrtimin e njohjes së Kosovës, ka votuar për sikurse anëtari boshnjak Shefik Xhaferoviq.

Vendimi në presidencë trepalëshe merret me konsensus të tre anëtarëve.

"Dodik nuk e pranoi njohjen e Kosovës si shtet të pavarur. Ne votuam 2-1 për atë vendim. Dodik ishte kundër dhe kjo do të jetë një temë në javët e ardhshme. Pritet që Dodik të kërkojë një seancë të Asamblesë Kombëtare të Republikës Serbe dhe t'i paraqesë ato tema ku ndërlidhen Kosova dhe Republika Srpska. Kjo është një temë e rrezikshme që mund të përshkallëzohet me historinë e ndarjes dhe supozoj se të gjithë e dini ku na çon tërë kjo", ka thënë Komshiq.

Ai shtoi se Kosova është një realitet, është një shtet i



pavarur. "Kushdo që ka frikë nga një vendim si njohja e Kosovës nuk duhet të ulet në

Presidencën e Bosnje dhe Hercegovinës", u shpreh Komshiq.

Kërkesa për shqyrtimin e njohjes së pavarësisë së Kosovës u bë nga anëtari i presidencës, Zelko Komshiq, pasi që anëtari tjetër i presidencës, Millorad Dodik, ka kërkuar që në seancë të diskutohet zhvendosja e Ambasadës së Bosnjës nga Tel Avivi në Jerusalem. Por, as për zhvendosjen e ambasadës nuk u arrit konsensus në presidencën e Bosnje dhe Hercegovinës.

Ndryshe, në kuadër të një marrëveshjeje me Kosovën, të nënshkruar në Uashington më 4 shtator, Serbia ka rënë dakord për zhvendosjen e ambasadës së saj nga Tel Avivi në Jerusalem.

Kryeministri Avdullah Hoti ka raportuar në Kuvend për procesin e dialogut me Serbinë

Opozita kritikon Hotin për dialogun me Serbinë



Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës kanë kritikuar kryeministrin Avdullah Hoti për lëshimet e bëra në marrëveshjen me Serbinë të arritur në Uashington. Deputetët e LV-së kanë vlerësuar se me këtë marrëveshje ka fituar Serbia dhe jo Kosova, kurse ata të PDK-së kanë deklaruar se qeveria aktuale po tenton ta hapë pakon e Ahtisarit në procesin e Brukselit. Kryeministri Hoti i ka mohuar këto pretendime, duke thënë se në Bruksel do të bisedohet vetëm për njohje reciproke

saj”, ka deklaruar Selimi. Kurse deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka deklaruar se delegacioni i Kosovës nuk ka negociuar fare për marrëveshjen në Uashington. Hoxhaj ka thënë se ajo që është arritur në Shtëpinë e Bardhë është meritë e amerikanëve dhe jo e delegacionit të Kosovës. Ai e ka kritikuar qeverinë se ka pranuar që nga dokumenti të largohet pika që parashihet njohjen e ndërsjellë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. “Ajo çka po ndodh këto ditë është hapja e Pakos së Ahtisarit. Dhe ky është shqetësimi ynë dhe nuk ka të bëjë me atë se unë jam në opozitë, por po e them në mënyrën më të sinqertë. Paragrafi i marrëveshjes së Uashingtonit, që flet për kishat, është hapje e pakos së Ahtisarit. Sot në Bruksel, kur Skënder Hyseni flet për aranzhimet për komunitetin joshumicë, është hapje e Pakos së Ahtisarit”, ka deklaruar Hoxhaj.

Hoti: Me Serbinë negociojmë vetëm për njohje të ndërsjellë

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se në procesin e Brukselit nuk do të hapet çështja e asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Gjatë raportimit në Kuvend ai ka deklaruar se me Serbinë do të negociohet vetëm për njohje të ndërsjellë. “Integriteti territorial është i panegociueshëm dhe nuk është shtruar si çështje para meje. Organizimi kushtetues i Kosovës nuk bën të preket. Nuk ka Asociacion me kompetenca ekzekutive në Kosovë. Për këto dy parime të dialogut, ka mbështetje të plotë nga partnerët tanë ndërkombëtarë. Parimi i tretë është se marrëveshja duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës”, ka deklaruar Hoti. Hoti ka deklaruar se me marrëveshjen e arritur, Kosova do të kthehet në epiqendër të aktivitetit ekonomik infrastrukturor. “Investimet e mëdha infrastrukturore dhe sjellja e gazit në Kosovë do të jenë infuzion i madh për zhvillimin e ekonomisë së vendit tonë”, është shprehur ai. Sipas tij, me këto projekte Kosova kthehet në qendër të aktivitetit ekonomik në rajon dhe më gjerë sa i përket komunikacionit rrugor dhe hekurudhor, duke lidhur Selanikun me Durrësin. “Ky është një momentum i ri ndërkombëtar i marrëdhënieve BE-ShBA, i cili ka për qëllim të prodhojë një projekt përfundimtar normalizimi dhe paqeje, përmes njohjes në mes

të Kosovës dhe Serbisë”, ka deklaruar ai. Në këtë seancë Hoti ka marrë mbështetjen e partnerëve të koalicionit qeverisës për këtë proces. Deputetja e AAK-së, Time Kadrijaj, ka deklaruar se Kosova me marrëveshjen e Uashingtonit ka bërë një hapë përpara në procesin e dialogut me Serbinë. Para deputetëve, ajo ka thënë se ShBA-ja në këtë proces ka konfirmuar edhe një herë interesin strategjik për paqe, për prosperitet ekonomik dhe për stabilitet në rajon. Ajo ka deklaruar se parimet e dialogut të cilat i ka prezantuar kryeministri Hoti janë qëndrime që AAK-ja i ka mbështetur dhe do t'i mbështesë deri në fund. “Parimi numër një lidhet me tërësinë territoriale të Kosovës dhe mosdiskutimin e asnjë teme që ndërlidhet me kufirin e përcaktuar me Kushtetutën e Kosovës ashtu siç është e paraparë në pika kufitare. Ne qëndrojmë të paluhatshëm në këtë temë”, ka deklaruar Kadrijaj. Më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë kryeministri Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, kanë nënshkruar një marrëveshje për normalizim të marrëdhënieve ekonomike. Marrëveshja është nënshkruar në prani të presidentit amerikan, Donald Trump.

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Dy partitë opozitare, Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kanë kritikuar kryeministrin Avdullah Hoti për marrëveshjen me Serbinë të arritur në Uashington. Në seancën në të cilën ka raportuar kryeministri për dialogun me Serbinë, deputetët e këtyre dy partive kanë thënë se në këtë marrëveshje qeveria bëri koncesione për Liqenin e Ujmanit, për pranimin që Kosova të futet në nismën e mini-Shengenit dhe për heqjen e pikës nga marrëveshja ku flitej për njohjen reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep

Selimi, ka kritikuar kryeministrin Avdullah Hoti lidhur me marrëveshjen e arritur në Uashington më 4 shtator. Ai ka thënë se në Uashington ka fituar Serbia dhe jo Kosova. “Kosova nuk del me fitore nga nënshkrimi juaj, zotëri Hoti. Nga ai nënshkrim më së shumti kanë përfituar të tjerët. Në këtë rast, përfituesi më i madh del Serbia sepse përfitoi dalje në Adriatik, bashkëpronësi në Ujman, zhbërje të kufirit shtetëror, pra nga kufij shtetërorë në pikë të kalimit të përbashkët, realizimin e idesë për mini-Shengen që, në fakt, është zonë e Novi Sadit. E stopon Kosovën në njohjet e saj, e stopon Kosovën për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe, mbi të gjitha, e kthen Kosovën shumë prapa në shtetbërjen e



FLET PËR "EPOKËN E RE", SABRI KIÇMARI

KOSOVA KA BËRË KONCESIONE TË PAPRITURA NË UASHINGTON

Dokumenti i Uashingtonit është akt joformal dhe juridikisht jodetyrues

Njohësi i marrëdhënieve ndërkombëtare, Sabri Kiçmari, ka kritikuar marrëveshjen në Uashington të arritur më 4 shtator. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se me këtë dokument Kosova ka bërë koncesione të papritura. Ish-ambasadori i Kosovës në Austri ka thënë se dokumenti i nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë nga Kosova dhe Serbia nuk është marrëveshje as bilaterale, as trilaterale dhe as ndërkombëtare. Sipas tij, me këtë rast kemi të bëjmë me një akt joformal dhe juridikisht jodetyrues

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Ish-ambasadori i Kosovës në Austri, Sabri Kiçmari, ka bërë me dije se zotimet e Uashingtonit janë të dëmshme për Republikën e Kosovës. Ai ka deklaruar se Kosova në Shtëpinë e Bardhë ka

bërë koncesione të papritura. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", njohësi i marrëdhënieve ndërkombëtare ka vlerësuar se delegacioni i Kosovës nuk është dashur të pranojë një dokument në të cilin nuk është futur asnjë pasues për njohje reciproke. "Kosova, në fakt, ka bërë koncesione të

papritura në Uashington. Ka pranuar që të mos futet asnjë pasues në lidhje me njohjen e ndërsjellë në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Insistimin serb për t'u hequr kjo pikë, delegacioni i Kosovës nuk ka arritur ta menaxhojë në rrafshin diplomatik. E vetmja gjë pozitive që ka ndodhur në

Uashington, më 4 shtator, është njohja nga Izraeli", ka thënë Kiçmari.

Ai ka deklaruar se delegacioni i Kosovës nuk kanë qenë i vetëdijshëm për disa lëshime që i ka bërë në Uashington. "Duke pranuar moratoriumin për mosaplikim në organizata ndërkombëtare, delegacioni i Kosovës ka ndihmuar në dobësimin e pozitës së Republikës së Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kam përshtypjen se anëtarët e delegacionit nuk kanë qenë të vetëdijshëm për rëndësinë simbolike të këtij elementi shtetësie, të drejtës për aplikim në organizata ndërkombëtare", është shprehur ai.

Njohësi i marrëdhënieve ndërkombëtare ka vlerësuar se me dokumentin e Uashingtonit nuk kemi të bëjmë me

marrëveshje ndërkombëtare. "Së pari më lejoni të konstatoj se nuk kemi të bëjmë me marrëveshje as bilaterale, as trilaterale dhe as ndërkombëtare. Nuk ka një dokument të nënshkruar nga të dy, përkatësisht tri palët. Hoti dhe Vuçiçi kanë nënshkruar një tekst me titullin: 'Normalizimi ekonomik'. Ata nuk e kanë nënshkruar të njëjtin dokument, edhe pse teksti është identik, me përjashtim të pasuesit të fundit. Dokumenti i nënshkruar nga z. Hoti nuk është dërguar, dhe nuk mund të dërgohet në parlament për ratifikim sepse nuk është marrëveshje ndërkombëtare dhe ndërshtetërore dhe nuk ka pasoja legale dhe as obligime ligjore", është shprehur ai, duke shtuar se kemi të bëjmë me një akt jodetyrues. "Pra, kemi të bëjmë me një akt joformal dhe juridikisht jodetyrues. Thjesht,



tjetër, më ndryshe”, është shprehur Kijçari.

“Epoka e re”: Z. Kijçari, e keni kritikuar marrëveshjen në Uashington të nënshkruar më 4 shtator. Pse mendoni se është e keqe për Kosovën kjo marrëveshje?

Kijçari: Janë një numër çështjesh të cilat më kanë shtyrë të mbaj qëndrim kritik ndaj dokumentit me titull “Normalizimi ekonomik” të nënshkruar nga kryeministri Hoti në Uashington. Përmes këtij dokumenti z. Hoti ka krijuar hapësirë shumë të madhe për depërtimin e mallrave serbe në Kosovë, ka premtuar ta mbështesë Serbinë për të depërtuar mallrat e saj në një port në Adriatik (çuditërisht pa u pyetur fare Shqipëria!), ka pranuar lejimin e përfshirjes të drejtpërdrejtë të Beogradit (për fizibilitet) në Liqenin e Ujmanit, ka mbështetur idenë e mini-shengenit (përmes së cilës lehtësohet depërtimi i mallrave serbe gjithandej në rajon), ka premtuar rënien dakord të Kosovës për ta zbatuar moratorium njëvjeçar për të mos kërkuar anëtarësim në organizatat ndërkombëtare etj. Nëse këto premtime të z. Hoti realizohen, do të ketë pasoja për të hyrat buxhetore, për shkak të një raporti të pabarabartë import-eksport me Serbinë, do të dëmtohen rëndë prodhuesit vendorë, i është premtuar Serbisë të jetë palë në një aset të rëndësishëm shtetëror, siç është Liqeni i Ujmanit dhe është dëmtuar subjektiviteti shtetëror i Republikës së Kosovës, duke pranuar moratorium kandidimi për pranim në organizata ndërkombëtare.

“Epoka e re”: Kryeministri dhe

anëtarët e tjerë të delegacionit të Kosovës thonë se me këtë marrëveshje është fuqizuar ndërkombëtarisht Republika e Kosovës?

Kijçari: Kosova, në fakt, ka bërë koncesione të papritura në Uashington. Ka pranuar që të mos futet asnjë pasues në lidhje me njohjen e ndërsjellë në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Insistimin serb për t’u hequr kjo pikë, delegacioni i Kosovës nuk ka arritur ta menaxhojë në rrafshin diplomatik. E vetmja gjë pozitive që ka ndodhur në Uashington, më 4 shtator, është njohja nga Izraeli. Por, njohja nga Izraeli nuk ka asgjë të bëjë me Serbinë dhe raportet shqiptaro-serbe. Pastaj janë disa elemente bazike shtetësie që nuk duhet vënë në diskutim me askënd dhe asnjëherë: territori, organizimi i brendshëm administrativ, sistemi kushtetues dhe statusi i shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Duke pranuar moratoriumin për mosaplikim në organizata ndërkombëtare, delegacioni i Kosovës ka ndihmuar në dobësimin e pozitës së Republikës së Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kam përshtypjen se anëtarët e delegacionit nuk kanë qenë të vetëdijshëm për rëndësinë simbolike të këtij elementi shtetësie - të drejtës për aplikim në organizata ndërkombëtare.

“Epoka e re”: A mund të bëjnë diçka qeveritë e ardhshme për të mos i zbatuar disa prej këtyre zotimeve që mund të konsiderohen të dëmshme?

Kijçari: Së pari më lejoni të konstatoj se nuk kemi të bëjmë me marrëveshje as bilaterale, as trilaterale dhe as ndërkombëtare. Nuk ka një dokument të

nënshkruar nga të dy, përkatësisht tri palët. Hoti dhe Vuçiqi kanë nënshkruar nga një tekst me titullin “Normalizimi ekonomik”. Ata nuk e kanë nënshkruar të njëjtin dokument, edhe pse teksti është identik, me përjashtim të pasuesit të fundit. Dokumenti i nënshkruar nga z. Hoti nuk është dërguar, dhe nuk mund të dërgohet në parlament për ratifikim sepse nuk është marrëveshje ndërkombëtare dhe ndërshtetërore dhe nuk ka pasoja legale dhe as obligime ligjore. Pra, kemi të bëjmë me një akt joformal dhe juridikisht jodetyrues. Thjesht, fjala është për një akt politik e jo për një akt ligjor. Sa i përket rrafshit politik, varet shumë se çfarë do të ndodhë më 3 nëntor 2020 në ShBA. Në rast se presidenti Trump do të fitojë një mandat të dytë, ky dokument mund të konsiderohet edhe më tutje material orientues pune i Administratës së ShBA-së për raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në rast se në zgjedhje fiton ish-zëvendës-presidenti Biden, atëherë pres të ketë qasje tjetër, më ndryshe.

“Epoka e re”: Po për vazhdimin e procesit të dialogut në Bruksel, cili është vlerësimi juaj?

Kijçari: BE-ja është gjendur në një pozitë të palakmueshme. Një lloj pozite pat në rrafshin figurativ, me iniciativën diplomatike të ShBA-së. Ajo po përpiqet ta kompensojë këtë përmes vazhdimin të dialogut. Por, temat që i ka vendosur në tavolinë janë teknike. Nuk po është në gjendje të ndërmarrë hapin e duhur: iniciimin e njohjes së ndërsjellë në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Tri ditë pas ngjarjes në Uashington, z. Borrell i ftoi në Bruksel z. Hoti dhe Vuçiq. U

diskutua për bashkëpunimin ekonomik dhe për personat e pagjetur. Më 28 shtator është paralajmëruar një takim tjetër, në të cilin pritet të diskutohen çështjet financiare dhe çështja e asociacionit të komunave me shumicë serbe. Kam përshtypjen se diplomacia e BE-së ende po lëviz në terrenin e inefficiencës, që determinohet edhe nga fakti se pesë vende nuk e kanë njohur Kosovën.

“Epoka e re”: Në këtë proces Kosova po synon ta marrë njohjen reciproke, e Serbia po synon ta marrë një asociacion me kompetenca ekzekutive për komunat me shumicë serbe në Kosovë. Si e shihni epilogun e këtij procesi?

Kijçari: Vuçiqi operon me një sintagmë tregtari në lidhje me raportet Kosovë - Serbi: “Kosova nuk mund t’i fitojë të gjitha dhe Serbia të mos fitojë asgjë”. Diplomacia jonë nuk ka qenë në gjendje t’i transmetojë në publikun ndërkombëtar fitoret e madhe që kanë realizuar serbët e Kosovës: garantimin e dhjetë vendeve në parlament, garantimin e përfaqësuesve serbë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, krijimin artificialisht të komunave me shumicë etnike serbe, gjuhën serbe si gjuhë zyrtare dhe të drejta të nivelit të lartë për pakicën serbe. Kosova duhet t’i shfrytëzojë më mirë këto elemente. Njohja e ndërsjellë është një imperativ kategorik për marrëdhënie të mira ndërfqinjësore. Por, një asociacion me kompetenca ekzekutive do ta dëmtonte funksionalitetin e Republikës. Gjykata Kushtetuese e ka dhënë mendimin e vet në lidhje me këtë. Delegacioni i Kosovës nuk do të duhej të hyjë në negociata antikushtetuese.

Tomë Gashi: Dosjet e dërguara në zyrat e OVLUÇK-së janë të Speciales

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka thënë se dokumentet e dërguara në OVLUÇK janë dokumente origjinale të Gjykatës Speciale.

Gucati ka thënë se të enjten kanë pasur një vizitë të pakëndshme në zyrat e OVLUÇK-së. “Sot kemi pasur një vizitë të pakëndshme në OVLUÇK. Këtu kanë ardhur hetuesit e Gjykatës Speciale. Me këshillën e avokatit Gashi këto materiale i dorëzuam. Tashmë, më në fund, është vërtetuar se këto dokumente janë të Gjykatës Speciale apo të Dhomave të Specializuara në

Hagë”, ka thënë Gucati.

Ndërsa avokati Tomë Gashi ka thënë se, duke u bazuar në logon e Gjykatës Speciale, vërtetohet se këto janë dokumente origjinale të tyre. “Vërtetohet se këto janë dokumentet e Gjykatës Speciale. Vërtetohet se këto dokumente janë të Gjykatës Speciale. Me këshillën time kryetari ka vendosur që tash t’ua dorëzojë. Në bazë të logos e shikoni që këto dokumente janë të Gjykatës Speciale, apo të Dhomave të Specializuara në Hagë”, ka thënë Gashi. Sipas tij, në dokumentet e publikuara në media duhet pasur kujdes për publikimin e emrave dhe mbiemrave që gjenden në dokumente.



Lëvizja Fol: Masat anti Covid s'po respektohen nga vetë qeveria

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Përfaqësues të Lëvizjes Fol kanë mbajtur të enjten konferencë për media, me ç'rast kanë shprehur shqetësimin e saj për moszbatim të vendimeve të institucioneve për parandalimin dhe luftimin e Covid-19 nga vetë institucionet publike.

Mexhide Demolli-Nimani, drejtoreshë ekzekutive e Lëvizjes Fol, ka thënë se kanë pranuar informata nga punonjës të institucioneve të ndryshme në nivel qendror, të cilët janë thirrur të dalin në punë me orar të plotë nga data 14 shtator. “Në anën tjetër, vendimi i datës 1 korrik 2020 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr. 11/09, i obligon të gjitha institucionet publike që të punojnë me staf të reduktuar dhe angazhimin e tyre me punë nga shtëpia, si dhe përgjysmimin e personave në secilën zyrë, dhe duke pasur parasysh që ende ka numër të lartë të rasteve me Covid-19, i njëjti vendim ende nuk është shfuqizuar apo ndryshuar”, ka thënë Demolli-Nimani. Sipas saj, edhe në vendimin e datës 28 korrik 2020, me Nr. 01/07, në pikën 11 të tij, institucionet publike obligohen që ta menaxhojnë paraqitjen e stafit në punë në përputhje me manualin për mbrojtjen nga

përhapja e Covid-19. “Për t'u mbrojtur nga pandemia Covid-19 dhe për ta parandaluar përhapjen e saj, një ndër masat e përgjithshme është paraparë edhe mbajtja e distancës, e cila është e pamundur të sigurohet nëse fillohet puna me staf dhe me orar të plotë nëpër institucionet shtetërore, ku numri i të punësuarve është relativisht i madh”, ka thënë ajo.

Në lidhje me këtë është nxjerrë edhe manuali për parandalimin dhe luftimin e Covid-19 ku, ndër të tjera, thuhet se “punëdhënësit duhet ta shqyrtojnë mundësinë e zhvillimit të rregulloreve dhe praktikave, siç janë oraret fleksibile (p. sh., puna nga shtëpia, ndërrimet e fuzionuara), për ta rritur distancën fizike ndërmjet punonjësve dhe të tjerëve”. “Gjithashtu, në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht në nenin 10, par. 4 dhe 7, thuhet: ‘Çdo person, institucion publik, privat apo publiko-privat, ka për detyrë që t'i zbatojë masat e përcaktuara nga organet kompetente për mbrojtjen nga Covid-19’. ‘Mosrespektimi i masave mbrojtëse përbën shkelje ligjore e cila ndëshkohet me këtë ligj dhe dispozitat ligjore në fuqi’. Marrë parasysh bazën ligjore në fuqi, vlerësojmë se masat e



marra nga Qeveria e Republikës së Kosovës në vendimet e lartcekura nuk janë duke u respektuar nga institucionet përkatëse”, ka thënë Demolli-Nimani. Erblin Hoxha, koordinator në Lëvizjen Fol, ka thënë se kanë pranuar raportime nga punonjësit e institucioneve publike të cilët përmes e-mail-ave janë njoftuar nga zyrtarët përgjegjës për rikthimin e tyre në vendin e punës me orar të plotë që nga e hëna e kësaj jave. “Duke qenë se hapësirat e këtyre institucioneve nuk janë

të bollshme në krahasim me numrin e lartë të të punësuarve, ministrinë nuk i përmbushin standardet për distancë fizike. Edhe pse statistikën për dënimet e shqiptuara ndaj qytetarëve dhe bizneseve janë publikuar, e ku janë mbi 18 mijë dënime të shqiptuara për mosmbajtje të maskës, apo distancës, ne nuk kemi shifra sa iu përket dënimeve të shqiptuara për personat zyrtarë apo institucionet publike për mosrespektim të masave anti Covid”, ka thënë Hoxha.

Ai ka pohuar se Lëvizja Fol e sheh me shqetësim vendosjen e standardeve të dyfishta, ku institucionet publike gjobisin qytetarët për mosrespektim të vendimeve të qeverisë dhe të udhëzimeve të institucioneve publike ndërsa, sipas tij, vetë institucionet duket që në heshtje kanë vendosur të mos i respektojnë ato. “Ne e vlerësojmë si të paligjshme vendimin e disa institucioneve publike për rikthim në punë të të gjithë stafit, me orar të plotë, pa vendim zyrtar”, ka thënë Hoxha.

MKRS-ja nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Institutin Albanologjik

PRISHTINË, 17 SHTATOR (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Institutin Albanologjik. Ky memorandum është nënshkruar në kuadër të Ditëve Evropiane të Trashëgimisë. Pas nënshkrimit të memorandumit, ministrja Dumoshi ka thënë se qëllimi i nënshkrimit të këtij memorandumit është realizimi i interesave të dyanshme në fushën e ruajtjes, mbrojtjes dhe komunikimit të trashëgimisë kulturore të Kosovës. Ministria Dumoshi ka theksuar se trashëgimia kulturore e shpirtërore është pjesë kyçe e programit qeverisës. “Pas nënshkrimit të këtij memorandumit na mundësohet realizimi i aktiviteteve dhe hulumtimeve shkencore me rëndësi për trashëgiminë

kulturore të Kosovës si pjesë e fushëveprimtarisë dhe programeve të punës të të dyja institucioneve në fushat specifike studimore si në etnologji, folkloristikë, etnomuzikologji dhe arkeologji”, ka thënë ministrja Dumoshi. Ajo ka theksuar se “në kuadër të muajit të trashëgimisë jemi të përkushtuar maksimalisht që ta ruajmë dhe promovojmë kulturën dhe traditën e vendit tonë”.

Ndërkaq drejtori i Institutit Albanologjik, Hysen Matoshi, ka falënderuar ministren Dumoshi për pritjen dhe ka thënë se pas nënshkrimit të këtij memorandumit do të realizojnë programe të përbashkëta për ruajtjen, mbrojtjen dhe komunikimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.



Limaj kërkon nga BE-ja ta mbajë fjalën rreth liberalizimit të vizave

PRISHTINË, 17 SHTATOR (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka pritur të enjten në takim shefin e ri të Zyrës së BE-së, njëherësh përfaqësuesin special të BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, të cilit i ka dëshiruar suksese në misionin e tij. Në këtë takim është disku-

tuar për zhvillimet aktuale në vend, me theks të veçantë liberalizimin e vizave për Kosovën dhe dialogun Kosovë - Serbi. Sipas njoftimit për media të Nismës, Limaj ka deklaruar se integrimet evropiane janë përcaktimi dhe orientimi ynë si vend. Ai ka ngritur çështjen e zvarritjes së

liberalizimit të vizave, duke shprehur pakënaqësinë për vonesën e panevojshme në këtë proces. Po ashtu, Limaj ka thënë se pret nga BE-ja që ta mbajë fjalën dhe t'i liberalizojë vizat për qytetarët e Kosovës në mënyrë që të rinjtë të lëvizin lirshëm në kryeqendrat evropiane.



Raporti i Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) për 24 orët e fundit

Tre të vdekur, 43 të infektuar dhe 239 të shëruar nga Covidi në Kosovë



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë ka njoftuar të enjten se janë shënuar edhe tri vdekje të njerëzve nga sëmundja Covid-19 në 24 orët e fundit. Kjo shifër e çon në 607 numrin e përgjithshëm të vdekjeve në Kosovë që nga fillimi i pandemisë. Sipas IKShPK-së, gjatë 24 orëve të fundit janë testuar gjithsej 664 mostra dhe prej tyre 43 persona kanë rezultuar pozitivë në koronavirus. Numri i përgjithshëm i të infektuarve, që nga mesi i muajit mars, ka arritur në 14 882

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 664 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 43 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar tri raste të vdekjes nga ky virus. Numri total i rasteve pozitive është 14 882 raste nga 60 235 persona të dyshimtë me këtë

virus dhe 607 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 239 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 12 188 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 087. Rastet pozitive në 24 orët e fundit janë nga: komuna Prishtinë 13 raste, komuna Skenderaj 6 raste, komuna Gjilan 4 raste, komuna Fushë Kosovë 3 raste, komuna Pejë 2 raste, komuna Deçan 2 raste, komuna Gjakovë 2 raste, komuna Mitrovicë 2 raste, komuna Prizren 2 raste dhe me nga një rast komunat Istog, Kaçanik, Malishevë, Shtime,

Suharekë dhe Vushtri. Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar të enjten se në institucionet publike shëndetësore në Kosovë aktualisht janë të shtrirë 250 pacientë, prej tyre 146 janë të prekur me koronavirus. Në raportin ditor të ShSKUK-së është thënë se pesë pacientë janë në respiratorë, 11 janë duke u trajtuar me makinat e frymëmarrjes CPAP, kurse 150 të tjerë janë në oksigjenoterapi. Kosova ka gjithsej 700 shtretër në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet rajonale.

Policia arreston tre persona të dyshuar për krime kibernetike

PRISHTINË, 17 SHTATOR (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar të enjten se në bashkëpunimin me Byronë Federale të Hetimeve (FBI) në Shtetet e Bashkuara ka arrestuar të mërkurën tre persona të dyshuar për kryerje të veprave penale "hyrje në sistem kompjuterik". Të dyshuarit E. J. (1998), Ç. B. (1998) dhe V. S. (1996) dyshohet se kanë shënjestruar platforma të ndryshme online dhe më

pas kanë kryer veprimtari të paligjshme kibernetike. "Të dyshuarit në vazhdimësi kanë vendosur dhe shitur të dhëna të ndryshme elektronike, të cilat paraprkishtë i kanë siguruar përmes veprimeve të paligjshme online, si kreditkartela të vjedhura në shumë shtete të botës, viruse të ndryshme kompjuterike, 'mjete' për sulme kibernetike, e-mail adresa dhe fjalëkalime, numra të telefonit si dhe të

dhëna të tjera", është thënë në njoftimin e policisë. Pas kontrollimit të dy lokacioneve, policia ka sekuestruar: shtatë shtëpiza kompjuteri, tre kompjuterë laptopë, katër hard disqe, shtatë telefona mobile, pesë USB memorie, dy mikro SD memorie, para të gatshme 2 625 euro dhe dokumente të tjera të ndryshme. Me vendim të prokurorit të dyshuarit janë dërguar në mbajtje.



Fillon pilotprojekti për regjistrimin e popullsisë në Kosovë

PRISHTINË, 17 SHTATOR (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka njoftuar se nga 15 shtatori ka filluar punën në terren për pilotregjistrimin e popullsisë, ndërsa ky pilot-projekt do të zgjasë deri më 14 tetor 2020. Sipas ASK-së, regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i paraprind realizimit të pilotregjistrimit, me qëllim të testimit të tërë procesit organizativ e zbatues. "Me qëllim të testimit të shumë aktiviteteve

dhe instrumenteve, bazuar në praktikat e mëparshme, si dhe rekomandimet ndërkombëtare, ASK-ja ka planifikuar që ta realizojë një pilotregjistrim nga 15 shtatori deri më 14 tetor 2020 në 13 komuna (Prishtinë, Fushë-Kosovë, Obiliq, Graçanicë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan, Ranillug, Prizren, Dragash, Mamushë, Pejë dhe Gjakovë). ASK-ja ka bërë përgatitjet e duhura për fillimin e zbatimit

të pilotregjistrimit në terren. Ndër të tjera, janë përgatitur pyetësorët, metodologjia, udhëzuesit, si dhe metoda e mbledhjes së të dhënave në terren (Metoda CAPI - Computer Assisted Personal Interview)", thuhet në njoftimin e ASK-së. Sipas ASK-së, është duke u realizuar mbledhja e të dhënave në terren dhe angazhuar rreth 60 regjistruar, 12 mbikëqyrës e 19 monitorues.



Prodhuesit kërkojnë garantim të veçantë kreditor për sektorin e tyre

PRISHTINË, 17 SHTATOR (ER) - Kompanitë prodhuese luajnë rol kyç në zhvillimin e ekonomisë së vendit, ndërsa koha e pandemisë ka krijuar mundësi të reja për depërtim të produkteve vendore në tregje ndërkombëtare e, megjithatë, përkrahja nga ana e qeverisë ndaj këtij sektori mbetet shumë e nevojshme. Këto u thanë në një forum virtual të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, ku bashkë me prodhuesit vendës u diskutua për gjendjen e sektorit të prodhimit.

Sami Dida, kryeshef ekzekutiv në kompaninë e prodhimit të kabllove "Proton Cable", tha se situata e krijuar me pandeminë ka ndikuar shumë në aktivitetin e kësaj ndërmarrjeje, derisa përmendi se në mënyrë zinxhirore janë afektuar pothuajse të gjitha industritë. Sipas tij, një nga problemet më madhore me të cilin janë ballafaquar ka qenë rritja e çmimit të lëndës së parë në një kohë kur shitjet janë në rënie.

Dida theksoi se Qeveria e Kosovës gjithsesi ka një rol për të luajtur në ndihmë ndaj kompanive prodhuese, ku tha se me disa pika shumë të thjeshta siç është përgjysmimi i TVSh-së mund të ndikojë pozitivisht në sektorin e prodhimit duke mundësuar avantazhe konkurruese në krahasim me vendet e tjera.

Më tutje, ai u shpreh se megjithëse është mirë që



Qeveria është fokusuar në ndihmë ndaj sektorit të bujqësisë dhe teknologjisë informative, pjesët e tjera të industrisë janë lënë mënjanë dhe kjo mund të shkaktojë disbalancime në ekonomi.

Ai foli edhe mbi nevojën për kontrollim të mallrave që hyjnë në Kosovë, ku tha se ekzistojnë mallra jashtë standardit që shiten në tregun tonë dhe konkurrojnë në çmim, andaj është e rëndësishme që kjo çështje të adresohet sa më parë. Kreshnik Jakupaj, përfaqësues nga kompania e prodhimit të letrës higjienike "Medruplast", theksoi se kjo kompani e ka përballuar pak më lehtë

ndikimin e pandemisë meqë kërkesa e madhe për produkte të së njëjtës i ka mundësuar kësaj ndërmarrjeje që t'i rrisë eksportet. Megjithatë, sipas tij, mungesa e theksuar e diasporës si dhe sjellja e ndryshuar e konsumatorit për shkak të nevojës së minimizimit të shpenzimeve, dukshëm ka krijuar vështirësi edhe për këtë kompani. Jakupaj theksoi se shpreson që sa më parë të aprovohet Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike, në mënyrë që të ndihmohet ekonomia e vendit. Më tutje, ai përmendi edhe nevojën për prioritizim të produkteve vendore, sidomos në tenderët

shtetërorë.

Kujtim Gjevori, kryeshef ekzekutiv në kompaninë e prodhimit të qeseve Scampa, njëherësh kryesues i Komitetit të Prodhimit të Odës Amerikane, foli mbi mundësitë e sektorit të prodhimit për zgjerim jashtë kufijve sepse, sipas tij, kjo periudhë ka krijuar nevojën për rritje të diversifikimit të riskut nga kompanitë e huaja, duke hapur rrugë për krijimin e partneriteteve të mundshme me kompanitë e Kosovës. Ai, gjithashtu, theksoi nevojën për adresim sa më të shpejtë të çështjes së pagesës së TVSh-së për lëndën e parë të blerë brenda vendit si dhe mungesën

e një rregullatori për kontrollimin e vonesave në pagesa.

Gjevori rëndësi të veçantë i dha çështjes së garancisë kreditore te kompanitë prodhuese, ku theksoi se duhet të parashihet deri në 80 për qind garantim i kredive dedikuar për prodhues, marrë parasysh kontributin e tyre në ekonominë e vendit. Gjithashtu, ai përmendi mundësitë e krijuara nga marrëveshja për normalizimin e raporteve ekonomike në mes të Kosovës dhe Serbisë, kurse tha se është e domosdoshme që aprovimi i Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike të bëhet sa më parë.

Nënshkruhet marrëveshja për fuqizimin e projektit të sektorit financiar

PRISHTINË, 17 SHTATOR (ER) - Zëvendësministri i Financave, Agim Krasniqi, dhe drejtori Menaxhues i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Besnik Berisha, kanë nënshkruar të enjten marrëveshjen e veçantë në kuadër të Marrëveshjes Financiare lidhur me Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar. Marrëveshja e veçantë mundëson realizimin e Projektit për Fuqizimin e

Sektorit Financiar i cili financohet përmes huamarrjes nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim, anëtar i Bankës Botërore. Projektin për Fuqizimin e Sektorit Financiar synon ta përmirësojë qasjen në financim për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, duke përfshirë segmente specifike dhe sektorë që kanë rëndësi strategjike, duke mbështetur rritjen e qendrueshme të ekonomisë së

Kosovës, si dhe synon t'i avancojë kapacitetet financiare dhe teknike të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore përmes sigurimit të asistencës teknike. Këto mjete do t'i komplementojnë përpjekjet dhe masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në kuadër të Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike dhe luftimin e efekteve negative të shkaktuara nga Covid-19 në ekonominë vendore.



Bizneset që nga fillimi i pandemisë Covid-19 kanë humbur 1 miliard euro

Përfaqësuesit e Odave Ekonomike në Kosovë, Berat Rukiqi dhe Arian Zeka, kanë thënë se gjendja ekonomike është e rëndë dhe institucionet po tregojnë paaftësi për trajtimin e kësaj gjendje. Sipas tyre, është për keqardhje mosratifikimi i Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, kur dihet se që nga fillimi i pandemisë Covid-19 bizneset e sektorit privat kanë humbur 1 miliard euro



Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë se është për keqardhje mosvotimi i Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. "Tash disa muaj prej kur dy odat kanë bashkuar forcat në shumicën e rasteve për t'i adresuar problemet e sektorit privat gjatë pandemisë, është për keqardhje jo vetëm fakti që

deputetët kanë qenë në pushim për më shumë se një muaj, por edhe që në seancën e parë pas kthimit nuk e votojnë një ligj që është esencial për ringjalljen ekonomike tash pas efekteve që ka shkaktuar pandemia. Hapen investime për mundësi të reja infrastrukturore që i nevojiten Kosovës, investime në transport

dhe investime që e shndërrojnë Kosovën. Ky ligj është mjaft me rëndësi për vendin, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë ekonomike të shkaktuar nga Covid-19. Debatimi në Kuvend është i natyrës politike. Kemi nevojë për reformimin e sistemit të drejtësisë dhe atij edukativ", ka thënë ai.

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Nga fillimi i pandemisë Covid-19 e deri më tani humbjet e bizneseve në vend janë 1 miliard euro, që është një alarm për vendimmarrësit. Kështu është thënë në konferencën e përbashkët të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka deklaruar se nëse nuk intervenohet, kolapsi ekonomik është i pashmangshëm që, sipas tij, do të ketë mbyllje të vendeve të punës dhe

falimentim të bizneseve. "Nga fillimi i pandemisë Covid-19 humbjet në ekonomi janë në vlerën 1 miliard euro dhe duhet ndërhyrë shpejt për pjesën e përgjegjësive që ka qeveria për adresimin e kësaj situatë të rëndë. Nëse nuk intervenohet me mjete në ekonomi gjatë fundit të këtij muaji dhe fillimi të tetorit kolapsi është i pashmangshëm me mbyllje të vendeve të punës dhe të bizneseve", u shpreh Rukiqi. Ai ka deklaruar se gjendja ekonomike është e rëndë dhe institucionet po tregojnë paaftësi për trajtimin e kësaj gjendje.

Ndërkaq kryetari i Odës

Kuvendi sërish dështon ta votojë Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike



PRISHTINË, 17 SHTATOR - Për shkak të mungesës së kuorumit, Kuvendi i Kosovës nuk arriti të votojë të enjten Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike Covid-19.

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se kjo pikë do të shtyhet për seancën e ardhshme plenare. Votimi i këtij projektligji do t'iu mundësonte qytetarëve kontributpagues të tërheqin 10 për qind të mjeteve nga llogaria e tyre në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Deri më tani vlera e mjeteve në Fondin e Kursimeve

Pensionale të Kosovës ka arritur mbi 2 miliardë euro me rreth 690 mijë kontributpagues. Kjo i bie që vlera e përgjithshme që do të mund të tërhiqej nga Fondi është rreth 200 milionë euro, mjete këto që, sipas zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës, janë konsideruar se do ta stimulonin kërkesën agregate në treg.

Projektligji për rimëkëmbje ekonomike, që më 22 korrik u miratua në Qeverinë e Kosovës, kap vlerën prej 385 milionë eurove. Ky projektligj synon që përmes politikave fiskale dhe

monetare t'iu ndihmojë bizneseve pas humbjeve të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit.

Shumica e bizneseve në Kosovë, gati në të gjithë sektorët, kanë raportuar vlera të mëdha të humbjeve financiare dhe zvogëlim të kapaciteteve prodhuese, nga masat e marra nga qeveria më 13 mars për parandalimin e pandemisë. Përfaqësuesit e bizneseve në vazhdimësi u kanë bërë thirrje autoriteteve të Kosovës që sa më shpejt të ndihmojnë në rimëkëmbjen ekonomike, pasi

që çdo vonesë, sipas tyre, do të sillte probleme më të mëdha për bizneset dhe rrezik të falimentimit të tyre.

Deri më tani nuk ka ndonjë vlerë të saktë të humbjeve që mund t'i jenë shkaktuar ekonomisë së Kosovës në përgjithësi. Humbjet ekonomike që janë shënuar deri më tani kanë të bëjnë me të hyrat tatimore dhe doganore. Sipas të dhënave të dy institucioneve, Administratës Tatimore dhe Doganave të Kosovës, janë mbi 232 milionë euro më pak të hyrat buxhetore për këtë vit si pasojë e

pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi.

Kosova deri më tani ka zbatuar Pakon Emergjente Fiskale në vlerë të rreth 180 milionë eurove. Kjo pako, e cila kishte për qëllim t'i zbuste problemet ekonomike dhe sociale, ishte miratuar në muajin mars, pas konfirmimit të rasteve të para me koronavirus nga qeveria e udhëhequr nga ish-kryeministri Albin Kurti. Kurse disa nga masat e saj janë duke u zbatuar pas ardhjes së qeverisë së udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti.

Ministrja Dumoshi viziton Dresnikun, vendin e rëndësishëm arkeologjik

KLINË, 17 SHTATOR (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, të enjten ka vizituar Komunën e Klinës. Ajo është pritur nga kryetari i kësaj komune, Zenun Elezaj, me të cilin kanë vizituar Dresnikun. "Morëm shkas nga ditët evropiane të trashëgimisë që ta vizitoj Klinën, ku u mirëprita nga kryetari i komunës, Zenun Elezaj. Ishim në Dresnik, aty ku ndodhet një nga gjetjet më të bukura e më të rëndësishme arkeologjike në Kosovë, mozaiku shumëngjyrësh i Dresnikut. MKRS-ja, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe Komuna e Klinës në partneritet me organizatën European Heritage Volunteers po

zhvillojnë aktivitetin e gjurmimit të mëtejshëm të Mozaikut të Dresnikut", ka thënë Dumoshi. Ajo ka thënë se MKRS-ja ka mbështetur financiarisht akomodimin e studentëve ndërkombëtarë të cilët do të gërmojnë, pastrojnë e konservojnë mozaikun nën mbikëqyrjen e arkeologut Elvis Shala. "Studentët ndërkombëtarë vijnë nga ShBA-ja, por edhe nga vende që nuk e kanë njohur Kosovën si Spanja, India dhe Sllovakia. Kjo është një dëshmi që trashëgimia jonë kulturore është aq e pasur sa ka nxitur interesimin e të huajve dhe ekspertëve të trashëgimisë. E njoftova kryetarin që do të përpiqemi që si ministri ta mbështesim Klinën edhe në



projekte që lidhen me fusha të tjera. Përmes afirmimit të trashëgimisë sonë të pasur

kulturore kontribuojmë që diplomacia kulturore të shërbejë për njohjen e shtetit të Kosovës

nga ato vende që akoma nuk na kanë njohur si shtet", ka thënë Dumoshi.

Lladrovci falënderon KFOR-in zviceran për bashkëpunimin në ruajtjen e sigurtisë publike



DRENAS, 17 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me nënkryetarin Nazmi Hasi, ka pritur në takim lamtumirës kapitenin e ekipit të KFOR-it LMT K9 nga Zvicra, Lewis Sutter, i cili përfundon misionin si dhe është njoftuar me nëntogerin e ri Bruno Znavit, i cili ka marrë kryesimin e misionit të KFOR-it zviceran në Kosovë.

Lladrovci ka falënderuar KFOR-in zviceran për bashkëpunimin në ruajtjen e sigurtisë publike në vend dhe përkrahjen ndaj Komunës së Drenasit. Përfaqësuesit e KFOR-it LMT K9 nga Zvicra kanë falënderuar kryetarin Lladrovci për bashkëpunimin gjatë kësaj periudhe dhe kanë shtuar se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe më tutje në

funksion të ruajtjes së sigurtisë publike. Në shenjë falënderimi për bashkëpunim, KFOR-i zviceran i dhuroi kryetarit Lladrovci flamurin e Zvicrës. Ndërsa kryetari Lladrovci, në shenjë mirënjohje dhe respekti për ta, u ka dhuruar varëse të punuara nga gratë e Organizatës 'Qendra për Promovimin e Drejtave të Grave' në Drenas.

Haskuka viziton fermerët të cilët kanë përfituar subvencione

Prizren, 17 shtator (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agron Limani, kanë vizituar njërin nga 16 fermerët të cilët kanë përfituar subvencione në kuadër të projektit "Ngritja e

pemishtes me pemë të imëta-dredhëza". Ky projekt ka për qëllim furnizimin e tregut me prodhime të freskëta vendore dhe rritjen e sipërfaqeve të mbjella me pemë të imëta, duke synuar zhvillimin e ekonomisë së vendit dhe rritjen e mirëqenies së familjeve të fermerëve.



Të prekurit me Covid-19 në Malishevë nuk po i respektojnë masat e IKShPK-së

MALISHEVË, 17 SHTATOR (ER) - Komiteti për Shëndetësi në Komunën e Malishevës ka mbajtur mbledhjen e katërt të rregullt, të cilën e ka drejtuar kryesuesi Alban Mazreku, i cili para anëtarëve ka propozuar rendin e ditës. Pas miratimit të proceverbaltit të mbledhjes së kaluar u debatua për situatën me pandeminë Covid-19, ku anëtari

Bedri Kryeziu ka ngritur shqetësimin se ka të prekur me Covid-19, të cilët nuk po i respektojnë masat e IKShPK-së, duke dalë në publik. Sipas tij, kjo paraqet rrezik dhe mundësi për hapjen e pandemisë, prandaj ka bërë thirrje që të merren masa institucionale ndaj atyre personave të cilët shkelin masat në fuqi kundër pandemisë Covid-19.

Më pas anëtarët e komitetit për shëndetësi vizituan drejtoreshën Feride Hoxha, që nga afër u njohën me kërkesat që ka Handikosi në Malishevë, shërbimet që ofron dhe nevojat që ka ky institucion për fëmijët me nevoja të veçanta në kohë pandemie. Ky komitet vazhdoi edhe me vizita në disa QMF të Komunës së Malishevës.



Ujmani është toka jonë



Shkruan: Albin KURTI

Ujmani nuk është pasuri natyrore, por liqe artificial. Ujmani është pasuri sepse është pasuri e Kosovës; jo pasuri natyrore, sepse është i ndërtuar nga dora e njeriut. Ujmani nuk është ujë. Ujmani është tokë sepse njëherë është tokë e pastaj ujë. Ujmani është tokë e mbushur me ujë.

Sipërfaqja e plotë mbi cilën është ndërtuar Ujmani është pronë e Kosovës. Kadastrë, pra pronësia, shtrihet më tej se kufiri shtetëror i Republikës së Kosovës me Serbinë. Andaj Ujmani edhe në territorin e Serbisë është i Kosovës. Ujmani është tokë e Kosovës në territor të Serbisë. Por, edhe atje ai është i Kosovës.

Planifikimi, projektimi dhe ndërtimi janë bërë me shpallje të interesit të Kosovës, me mjete të Kosovës, i destinuar për Kosovën, në kohën kur Kosova ishte krahinë socialiste autonome e federatës.

Ujmani nuk është liqe natyror. Aty para ujit ka pasur toka, të cilat i ka shpronësuar Kosova, sipas ligjeve në fuqi dhe ka paguar shtrenjtë për to.

Nuk ka pasur kontest me dikur republikat (sot shtete), pasi u shpërbë federata.

Ujmani nuk është ndërtuar në

bashkëpunim me Republikën tjetër (sot Serbia), as nuk ka pasur për destinim përdorimin e ujërave të grumbulluara në të nga të dy etnitet asokohe brenda federatës (sot shtete të pavarura), por vetëm dhe vetëm të Kosovës. Këtë e vërteton çdo dokument zyrtar, por edhe projektimi i këtij kompleksi ujqor-energjetik.

Fakti që nga pikëpamja e kufirit shtetëror ka pjesë të liqenit artificial të Ujmanit, pra tokave, në territorin e Serbisë, nuk thotë asgjë për pronësinë e tokës mbi të cilën sot ka ujë - ajo është aset i ndërmarrjes publike me qeverinë si 100 për qind aksionare në emër të

Republikës sonë. Ujmani është çështje prone, jo kufiri.

Ujmani nuk është rasti i liqenit natyror të Shkodrës, ku vet liqeni është ndarë midis shteteve, apo i liqenit tektonik të Ohrit. Por as nuk është rasti i marrëveshjes ndërkombëtare për shfrytëzimin e ujërave dhe më pas blerjen e tokës si të liqeni i Vërmicës në rastin e Shqipërisë me atëbotë Jugosllavinë.

Nuk ka pasur dhe as nuk ka për Ujmanin asnjë kontest të natyrës ndërkombëtare apo që lidhet në ndonjë formë me të drejtën ndërkombëtare të ujërave. Sepse askush nuk ka kontest për rrjedhën e lumit i

cili e mbush një pjesë të liqenit tonë artificial.

Koha kur Serbia mund të nxirrte pretendime për këtë kompleks siç është Ujmani ka qenë para më shumë se 40 vjetëve, kur shpallej interesi i Kosovës për projektim dhe shpronësime për këtë qëllim në nivel të federatës. Nuk mund të simulohet kontesti i pabërë 40 vite më parë sot më 2020. Sepse nuk ekziston më asnjë e drejtë. Gjithçka është ratifikuar në nivel federate në atë kohë dhe çështja është e mbyllur. Kushdo që po flet për Ujmanin si “ujëra që duhen ndarë” përveç që po ia ndihmon Serbisë të krijojë nga hiçi një

kontest të pronësive të Kosovës, njëkohësisht edhe po e shtron rrugën që të zgjidhet keq çështja e demarkimit të kufirit kurdo që ajo ndodh. Ujmani s’ka kontest, as nuk ka për çfarë të përdoret nga Serbia, as si e drejtë dhe as si aset, sepse nuk i ka takuar kurrë asaj dhe as nuk është ndërtuar për pjesë apo zona të saj.

Ujmani pra nuk i takon Serbisë e madje as nuk i duhet Republikës së Serbisë. Ujmanin duket që e kanë veçse për ‘Zajednicë’, si ujë për ‘Zajednicë’.

Ujmani është tokë, ujë dhe energji e Kosovës, nga Kosova, për Kosovën.



Kosovës s’i duhet opozitë emocionale (që ndjek lajmin), por një sosh racionale (që lajmi e ndjekë atë)!



Shkruan: Fadil MALOKU

1. Që në fillim duhet sqaruar distingsionin midis kornizës së të qenit opozitar racional dhe opozitar emocional. Opozitari racional, duke qenë i vetëdijshëm për pamundësinë e posedimit të argumentit të vendimmarrjes, në shumicën e rasteve është i detyruar ta përdorë trustin e mendjes apo

të radios në veprimet e veta ditore politike. Dhe këtë qasje ai duhet ta konsumojë e ta shfrytëzojë me elokuencë dhe me ndjenjë ekonomizimi, që nënkupton se çdo veprim pragmatik dhe praktik që e bën në skenën aktuale politike, duhet ta bëjë me saktësi milimetrike dhe mundësisht me fuqinë e argumentimit! Sidomos me faktin dhe aktin e transparencës dhe llogaridhënies publike, në mënyrë që kështu ta animojë online qytetarinë për temat e interesit publik.

2. Po pse opozitë emocionale, shtrohet pyetja? Në rastin tonë këtu aludimi është më shumë te Vetëvendosja sesa te PDK-ja

(e cila e gjendur ende në deliriumin e prijatarisë politike) ngase, ajo e ridëshmoi dhe e ridimensionoi këtë model të sjelljes, që në sociologjinë politike shihet dhe konsiderohet jo si përparësi, por si dobësi (kështu ka gjasa që të konsiderohet, sidomos në shoqëritë me traditë dhe përvojë të gjatë demokratike) politike. Arsyja është shumë e thjeshtë: Në politikën realiste, pastaj në pozicionimet blanko pro lidhshpimit global, e sidomos në shoqëritë që s’kanë pasur traditë demokratike, e as mundësi ndërtimi sovraniteti e pavarësie, sikurse jemi ne

kosovarët, nëse e tepron me “paradigmën e emocionalitetit”, gjasat për të mbetur pothuajse shumicën e kohës politike, në cilësinë dhe pozicionin e opozitarit, janë reale!

3. E si dhe çfarë duhet të bëhet LV? Natyrisht, pa asnjë dilemë, një këshilltar i strategjisë së komunikimit dhe një sish i komunikimit strategjik do të përgjigjej; opozitë racionale! Por, racionaliteti këtu më shumë ka të bëjë me raportin që ky subjekt e “ndërtoi dhe konsumoi” si mandat bashkëqeverisës me LDK-në. Ku LDK-ja finoke e (Isa Mustafës) njohur me “kulturën e cinizmit” dhe me traditën e

dredhive dhe oportunitetin politik që e trashëgoj padyshim nga grupet dhe klanet e shkollës (së Kumrovcit!) komuniste, që u infiltruan qysh nga koha e inaugurimit të Ibrahim Rugovës, arriti ta fus LV-në në grackën e emocionalitetit sociopolitik, ku asaj iu amputuan “thikat, hartat dhe gjaku”, që kinse po përgatitet jo në “shtëpinë e kuqe, e as atë të kaltër”, po pikërisht aty ky caktohen fatet e kombeve të vogla, pra, në Shtëpinë e Bardhë! Së këndejmi, Kosovës aktualisht i duhet një opozitë që di mundet dhe vepron në mënyrë milimetrike racionalisht, e jo emocionalisht!



Arta Marku: Pyetjet ekzistenciale që shtron letërsia

(Mbi librin “Bijat e gjeneralit” të Mimoza Hysës)

Dy motra binjake apo dy unë brenda të njëjtit njeri? Përplasja e dy karaktereve të ndryshme të dy vajzave apo përplasja e brendshme e individit? Të shohësh tjetrin përkundraill apo të shohësh veten në pasqyrë? Për luftën, përpjekjet, përplasjet. Për zbulimin e vetes, emocioneve, ndjenjave...

Ka shumë të ngjarë që lexuesi, Mimoza Hysën ta njohë si përkthyes dhe në fakt ajo ka sjellë autorë të rëndësishëm nga italishtja në shqip sikurse Unghereti, Quasimodo, Montale, Mazzantini, Buzzati, Tabucchi, Manfredi, Bevilacqua... Madje, më i fundit përkthim, ka mbërritur njëkohësisht me romanin e saj (“Me shaka”, i Domenico Starnones, i dyti prej autorit italian, pas librit “Lidhëset” – Botimet Albas)... E megjithatë, Hysa nuk është shkrimtare e kohëve të fundit. Është shkrimtare e vjetër tashmë. Unë e njoh, këtu e 15 vjet të shkuara, njëkohësisht si përkthyes dhe shkrimtare. Kurse BIJAT E GJENERALIT është libri i katërt i saj pas KOHA E ERËS, VENDIMI, HISTORI PA EMRA, sadoqë me një hapësirë tejet të gjatë kohore nga botimi i

fundit.

Por le të ndalim te BIJAT E GJENERALIT (botimet Onufri). Nuk e teproj po të them se është një nga librat më interesante dhe të papritur që kam lexuar këto kohë.

Në këndvështrimin tim Bijat., përbush 2 parime të rëndësishme që duhet t'i përbushë letërsia:

I pari, parimi **hedonistik**, ndryshe e thënë kënaqësia që merret gjatë leximit.

Ka një histori ky libër për të cilën lexuesi është kureshtar të mësojë vazhdimin. Dhe leximi, teksa është i rrjedhshëm, mbështillet edhe nga pamundësia për ta parashikuar çfarë sjell faqja pasardhëse.

Nga ana tjetër, pika e dytë e rëndësishme është: **të menduarit**. Pra libri nxit shtrimin e pyetjeve. Pyetje, për më tepër, mbi thelbin e njeriut që ka

brenda: TË MIRËN vs TË KEQEN; EGOIZMIN vs ALTRUIZMIN; KAOSIN vs RREGULLIN...

Në qendër të librit janë dy karaktere: Martina dhe Marsina që mund të jenë dy karakteret e dy vajzave të ndryshme, madje të kundërta ashtu sikurse mund të jenë dy të kundërtat që njeriu i ka brenda vetes.

Martina dhe Marsina janë dy binjake të një veze. Përkundër asaj që mund të imagjinohet, nuk është SIMBIOZA, shkrirja, çfarë i karakterizon. Përkundrazi është KONFLIKTI. Pikërisht, këto binjake janë në një konflikt të vazhdueshëm, të pambarimtë. Jetojnë në një familje. Kanë të njëjtin baba: gjeneralin. Kanë të njëjtat kushte jetese: një shtëpi mu në mes të bllokut. Por kanë mendime pa pika përkimi, shijojnë e gjykojnë nga kënde të ndryshme, të kundërta madje. Endrrat nuk u ngjajnë... Dashuritë aspak, ashtu sikurse fustanet, fjongot a lulkat. Rrëfejnë të dyja jetët e tyre dhe zbulojnë njëra-tjetrën, secila nisur nga këndet e veta të shikimit. Duhet dhe urrehen. Miqtë i kanë të ndryshëm. Fatet po ashtu.

Historia është intriguese, por

vështirë e rrëfyeshme me dy fjalë. Ama është një rrëfim thellësisht psikologjik.

Libri më solli në mendje një shkrimtare holandeze, Renate Doreshtejn, mbërritur në shqip disa vite më parë me librin “Albumi i familjes” (botimet Dituria). Ishte një detaj konkret, i përbashkët me shkrimtaren shqiptare që ma nxiti përkimin. Holandezja ka interpretime psikologjike të jashtëzakonshme në rrëfimin e saj ndaj dhe një gazetar e pat pyetur nëse kishte studiuar psikologji. Mesa duket ia kishte ngacmuar vëmendjen, veçmas, aftësia interpretuese psikologjike e shkrimtares. Por përgjigjja ishte e papritur: Jo, – thotë shkrimtarja – nuk kam studiuar psikologji. Ajo zbulon, me fjalë të tjera, se në jetën e përditshme i mungon tërësisht një aftësi e tillë shpjeguese dhe interpretuese. Ama ndryshon puna në momentet kur është shkrimtare. Kur është në proces, është psikologe gjithashtu. Me gjasë, kjo aftësi në aspektin psikologjik, ka të bëjë me shkrimtaren brenda njeriut. Me gjasë, shkrimtarët e vërtetë janë të tillë, gjithnjë, në tryezën e punës. Me gjasë, Mimoza Hysën e karakterizon gjithashtu një tipar i tillë brenda laboratorit të vet.

Por krahas psikologjisë është filozofia. Filozofi jete, konkluzione përvoje:

MBRETI LUAN VETËM NJË KUTI. ËSHTË SHUMË I NGATHËT. U DUHET TË TJERËVE TË TREGOHEN MË TË SHKATHËT SE AI. – shkruan Mimoza Hysa duke i vënë konkluzionet e saj në gojën e personazhit. Mesa duket jo më kot skakiera është e pajisur me kuaj e oficerë, me torra dhe ushtarë, me mbretëreshën padyshim, sikurse në skakierën jetësore nuk mjafton të jesh një mbret i vetëm. Prania e të gjithë “gurëve” është domosdoshmëri. PARIMET I VENDOSIN CAQET, – thotë diku tjetër, sërish personazhi, apo: FATET NGATËRROHEN EDHE NËSE TI QËNDRON SPEKTATORE”...

Por, le të ndalim pak te FATI. Personazhet e M.Hysës paraqesin dy pamje edhe në këtë aspekt, por nuk është e lehtë të thuhet se cila syresh është pamja ideale. Apo ndoshta pamja ideale nuk ekziston?

Për njërin prej personazheve: E NESËRMJA ËSHTË NJË DITË E RE, për tjetrën: E NESËRMJA ËSHTË AJO QË KA PLANIFIKUAR TË JETË. Për njërin, si më sipër, FATI NGATËRROHET EDHE NËSE TI QËNDRON SPEKTATORE. Për tjetrën EDHE RASTËSIA MERR FORMËN QË

AJO VETË I JEP.

Në fakt, a e ka njeriu FATIN E VET NË DORË? Apo RASTËSIA ËSHTË MBRET I FATIT? E nëse për një moment mendojmë se fatin e ka në dorë njeriu, deri në ç'pikë e ka?

BIJAT E GJENERALIT rreken të japin alternativat e tyre... personazhet pra.

Në një artikull mbi një libër duhet, doemos, njëfarë zbulimi i subjektit. Por, siç thashë më lart, "Bijat e gjeneralit" është vështirë i rrëfyeshem. Është libri tipik që mund të zbulohet, faqe pas faqeje, vetëm duke e lexuar. Gjithsesi, libri na vendos në Tiranën e viteve të diktaturës. Babai i vajzave është një personalitet i diktaturës, burri tipik që ka ngjitur shkallët e karrierës dhe ia di vështirësinë, jo vetëm ngjitjes por sidomos kujdesit që lipset për të mos rënë. Se gremi na është aty, ngjitas rrugës që bën ai përditë dhe një mosvëmendje e vogël mund të jetë fatale. Madje, për këtë, nuk mjafton të kujdeset veç ai, por i duhet edhe familjes. Gruas po se po. Por fundja ajo është si

plastelinë dhe merr lehtësisht formën që ia jep koha e vendi, domosdoshmëria. Jeta e saj është e kufizuar te jeta e të shoqit. E sheh si lokomotivën që tërheq pas vagonët mbi të cilët, më shumë sesa ajo vetë, qëndrojnë të bijat. Por u duhet edhe vetë vajzave të bëjnë kujdes. Se rreziku i një treni të tërë mund të vijë edhe nga një vagon i vetëm përsa kohë është i lidhur me hallka me të tjerët. Ndryshe e thënë, vajzave u duhet të mos e jetojnë jetën siç do ta kishin dashur. Për njërën është e lehtë. Për tjetrën e pamundur. Prandaj dhe tragjedia është e pashmangshme.

Zbulohen në libër historitë e vajzave, dashuritë e tyre, miqësitë që herë janë e herë s'janë të duhurat.

Ka dashuri tragjike, ka lidhje pragmatiste. Ka jetë të prangosura, kufij të rrezikshëm për t'u kapërcyer. Ka guxim për t'i kapërcyer e po aq pamundësi dëshpëruese që t'i fikin drita përfundimisht.

Janë të skalitura në libër personazhe qendrorë e periferikë që sidoqoftë, për nga fuqia, janë tronditës.

Ka rrëfime situatash ku njerëzit

humbin personalitetin e dinjitetin, por kurrë të gjykuara nga shkrimtarja që kërkon të thotë, edhe pse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, se të gjykojë apo të paragjykojë është rrugë e shkurtër e pa krye.

Rrjedha e ngjarjeve dhe fatet e personazheve janë kaq të papritura. Jo vetëm e Martinës dhe Marsinës, (njëra fllad pranvere, si marsi, muaji i lindjes – tjetra erë e ngarkuar me shi, si e marta, dita e lindjes), por edhe fati i të dashurit të Martinës, Jetonit, me kleçkë në biografi dhe me historinë e nënës së tij që ka shkelur mbi veten për të shpëtuar bijtë; edhe e Silvit, shoqes së pazakontë të Martinës, të cilën, realiteti që i ka takuar të jetojë e ka nxjerrë në margjina, deri edhe e Zanit, burrit të Marsinës, krejtësisht të qartë dhe pa dilema për rrugën që i duhet të ndjekë në mënyrë që të mos mbetet përjetësisht banori i një fshati të humbur.

Por si duhet të kenë ardhur këta personazhe me fatet e tyre? Një rrugë duhet të kenë ecur? A i ka pasur shkrimtarja në dorë fatet e tyre? Po jeta që gjallon në libër, në


momente udhëkryqi, pse merr një kthesë të caktuar e jo në një tjetër? Po emrat e personazheve çfarë duan të thonë (se duket qartë që fshehin kuptime)? Po babain pse bijat e thërresin gjeneral në një kohë kur gradat nuk ekzistojnë? Po fatet e dy binjakeve të një veze pse ecin në kahe të kundërta? Po jeta luksoze brenda një vile blloku pse nuk mjafton? Po personifikimi i dashurisë pse quhet Jeton dhe akoma më shumë pse fundi i tij është tragjik? A ka një shpjegim pse ai e lë pas veten te një pasardhës? Po një nënë, çfarë është në gjendje të bëjë për ta mbrojtur fëmijën e vet? Po bota që na rrethon është Ferri apo Parajsa? Për botën dhe njerëzit që e popullojnë; për jetën dhe konfliktet që prodhon; për familjen dhe individin brenda saj; për dallimet e mëdha që mund të gjenden mes gruas dhe burrit; për dashurinë dhe dilemën e madhe lidhur me të; për kthesat e papritura të fatit; për diktaturën dhe çmendurinë; për frikën dhe guximin e marrë... për pyetjet që nuk mundemi të mos i bëjmë dhe përgjigjet që me gjasë s'i marrim dot... për

këtë ekziston letërsia, ajo e mira.

"Unë edhe sot u frikem njerëzve që dinë se ç'bëjnë dhe kanë sigurinë e tepruar në bindjet e tyre, u frikem njerëzve që ndërtojnë sisteme të sigurta, nga të cilat nuk lëvizin presjet, u druham njerëzve me një gramatikë të pastër dhe sintaksë të ndërlëkuar ku të gjitha fjalitë lidhen mrekullisht me lidhëza bashkërenditëse dhe nënrenditëse. Fjali që e kanë pënë shkakore dhe prandaj përmblylëse. U frikem njerëzve që dinë t'u japin përgjigje të gjitha pyetjeve. Unë kam ditur vetëm të ngre pyetje në jetë Martinë dhe nëse jeta më ka dhënë ndonjëherë përgjigje, qoftë edhe të vonuar jam ndjerë e pjekur dhe e rritur. Për mua është e rëndësishme TË DISH TË BËSH PYETJE e jo të dish të japësh përgjigje...". shkruan në libër, Mimoza Hysa... dhe "Bijat e gjeneralit" është libri i pyetjeve të mëdha që njeriu e ka të nevojshme t'i bëjë, anipse përgjigjet më së shumti nuk janë apo janë të turbullta...

/exlibris.al/





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Krasniqi emërohet drejtor teknik në FBK

Ish-përzgjedhësi i Kosovës dhe trajneri i disa skuadrave të Superligës, Arben Krasniqi, është emëruar të enjten drejtor teknik në Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK)



PRISHTINË, 17 SHTATOR - Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) e ka emëruar Arben Krasniqin në pozitën e drejtorit teknik (drejtor i Programeve të Basketbollit) në FBK. "Përgjegjësitë kryesore të drejtorit teknik të FBK-së do të jenë: Ta menaxhojë Programin Nacional të Certifikimit të Trajnerëve për FBK dhe ShTBK; Ta zhvillojë dhe menaxhojë programin e trajnimit të trajnerëve të FBK-së; Ta menaxhojë Qendrën Nationale të Basketbollit dhe Akademitë të Basketbollit të krijuara në kuadër të kësaj qendre; Të koordinojë dhe menaxhojë të gjitha aktivitetet e shkollave dhe universiteteve për FBK-në; Të koordinojë dhe menaxhojë Kampin Nacional të FBK-së për gjeneratat e reja", thuhet në njoftimin e FBK-së. Ndërkaq drejtori teknik i FBK-së do

të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e pjesëmarrjes dhe të gjitha programeve të FBK-së, si dhe shërbimeve me përgjegjësi në fushën e zhvillimit të trajnerëve; Zhvillimit të lojtarëve; Qendrën Nationale të Basketbollit; Zhvillimin e Akademive të Basketbollit; Masivizimin dhe promovimin e Mini-Basketbollit në të gjitha regionet e Kosovës. Arben Krasniqi, ish-basketbollist dhe ish-përzgjedhës i Kosova A, e ushtron zejen e trajnerit prej vitit 2003, ndërsa ka të përfunduar disa trajnime për trajnerë në nivel të lartë ndërkombëtar. Ai ka udhëhequr disa skuadra të Kosovës, ndërsa suksesin më të madh e ka arritur me Prishtinën. Krasniqi do ta fillojë punën zyrtarisht me orar të plotë në zyrë të FBK-së nga 1 tetori.

Irma Konjusha operohet me sukses

Një nga lojtaret më të dalluara në basketbollin e femrave në Kosovë, Irma Konjusha, është operuar me sukses. Ajo është operuar në këmbën e djathtë (impigment) dhe do t'i mungojë skuadrës së saj, Kosovahome Prishtina, deri në muajin janar. "Operimi ka shkuar mirë. Tashmë do të fillojë faza e rikuperimit, që besoj se do të zgjasë deri në muajin janar. Besoj se do të rikthehem fuqishëm dhe të jem e gatshme për skuadrën. I falënderoj të gjithë për përkrahjen", është shprehur Konjusha për faqen zyrtare të FBK-së. Konjusha është një nga lojtaret më të dalluara në basketbollin e femrave, duke fituar disa trofe me Prishtinën dhe individuale.

SHKURT

Kumbulla: Do të jap gjithçka për Romën

Marash Kumbulla ka kaluar vizitat mjekësore te Roma dhe firmosur kontratën e tij për pesë vjet me ekipin verdhekuq, teksa te Verona kalon një futbollist i ri dhe huazimi me detyrim blerje për gati 30 milionë euro. Kumbulla bën transferin më të madh në karrierë dhe tashmë sezonin tjetër do të luajë për objektiva të mëdha dhe jo vetëm mbijetesën. "Dua t'i falënderoj mbështetësit e Romës për pritjen e ngrohtë që më kanë dhënë. Do të jap gjithçka që kam dhe do të provoj të fitoj dhe të festoj me ta", ka thënë Kumbulla.

Shqipëria nuk ndryshon pozitë në renditjen e FIFA-s, Kosova bie një pozitë me poshtë

FIFA ka publikuar renditjen e kombëtareve për muajin shtator dhe Shqipëria, që fitoi kundër Bjellorusisë dhe humbi ndaj Lituanisë, nuk ka ndryshuar pozicionin. Kuqezinjtë e drejtuar nga Edy Reja mbeten në vendin e 66, ndërsa Kosova ka pësuar rënie për një pozicion. Barazimi me Moldavinë dhe humbja me Greqinë kanë pasur ndikimin e vet dhe tani "dardanët" pozicionohen në vendin e 116. Belgjika mban vendin e parë dhe ndiqet nga Franca e Brazili, kurse në vend të katërt pozicionohet Anglia. Portugalia është ngjitur në vendin e pestë. Më pas renditen Uruguai, Spanja, Kroacia, Argjentina dhe Kolumbia.

Behrami, i 27-ti në renditjen e AIBA-s

Federata Ndërkombëtare e Boksit AIBA ka publikuar renditjen më të re të boksierëve për vitin 2020. Boksieri i Kosovës, Patriot Behrami, ndodhet në vendin e 27-të në botë në kategorinë -69 kilogramë, që vlerësohet sukses për të. Behrami ka tubuar 150 pikë, të cilat i ka fituar me vendin e pestë të zënë në Lojërat Evropiane Minsk 2019. AIBA në renditjen botërore merr parasysh vetëm pikët e fituara në Kampionatet Botërore, Kampionatet Kontinentale dhe Lojërat Evropiane, në të cilat gara pikë të fituara si senior ka vetëm Behrami. Patrioti merr bursë nga Komiteti Olimpik i Kosovës si "Shpresë Olimpik 2020".

Gashi jep dorëheqje nga posti i kryetarit të KB Peja

Art Gashi nuk do të jetë më kryetar i KB Pejës. Ai përmes një letre ka konfirmuar dorëheqjen nga ky post. "Ky është viti im i nëntë si kryetar i klubit qysh kur jam zgjedhur nga Kuvendi në shtator të vitit 2011. Pra, gati një dekadë në udhëheqje të njërit prej klubeve më të famshme të Kosovës dhe këtë e kam bërë me krenari dhe dinjitet, edhe pse kam kaluar shumë sfida e probleme", ka shkruar Gashi, i cili ka thënë se dëshiron të hapë rrugë për dikë që ka më tepër kohë dhe mundësi që të angazhohet më tepër për klubin.

Arben Beqiri mposhti sëmundjen, iu rikthye futbollit

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Futbollistëve të Kosovës ka njoftuar se portieri i Trepçës '89, Arben Beqiri, është shëruar plotësisht. Kryetari i ShMDFK-së, Visar Zogiani, ka zhvilluar një takim

me portierin Beqiri, i cili e falënderoi shoqatën dhe të gjithë ata që e ndihmuan gjatë kohës kur ishte i sëmurë. "Njoftojmë gjithë opinionin futbolldashës, edhe më gjerë, se portieri i KF Trepça '89, Arben Beqiri, është shëruar

plotësisht. Ai në një takim me kryetarin e ShMDFK, Visar Zogiani, shprehu falënderimet e tij dhe të familjes për të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë të cilët kontribuan në çfarëdo lloj forme që Arbeni së pari të jetë pranë familjes si

dhe t'i kthehet profesionit të tij, futbollit. Edhe ne si Shoqatë ju falënderojmë të gjithëve që i jeni përgjigjur pozitivisht iniciativës sonë dhe lutemi që mos të kemi raste të tilla më", thuhet në njoftimin e ShMDFK-së.



UEFA ndryshoi formatet e kualifikimeve për Ligën e Kampionëve për femra dhe në futsall

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Komiteti Ekzekutiv i UEFA-s ka vendosur ta shtyjë dhe ta ndryshojë formatin e disa garave për shkak të situatës aktuale me Covid-19 në të gjithë Evropën, në mënyrë që t'i lehtësojë rreziqet dhe njëherësh t'u japë klubeve dhe federatave kombëtare më shumë kohë për t'u përshtatur me situatën dhe të përgatiten plotësisht ndeshjet, udhëtimet si dhe zbatimin e protokollit të UEFA-s për "Kthimin në lojë". Kështu, rrethi elitë i kualifikimeve për Kampionatin Evropian të grupmoshës 19 vjeç, i paraparë të zhvillohej në tetor, është shtyrë për në nëntor. Ndërkohë, gara e Ligës së Kampionëve në konkurrencën e femrave, ku Kosovën e përfaqëson KFF Mitrovica, ka pësuar ndryshim. Kështu, mini-turnet e rrethit të parë do



të zëvendësohen me dy rrethe të eliminimit direkt me nga një ndeshje, ku pjesëmarrëse në rrethin e parë do të jenë 40 ekipe më 3 e 4 nëntor dhe 20 ekipet e kualifikuara në rrethin e dytë, më 18 e 19 nëntor. Ndryshim ka pësuar edhe formati i Ligës së Kampionëve në futsall, ku rrethi

paraeliminator, rrethi kualifikues dhe rrethi elitë që më parë ishin planifikuar në formë të mini-turneve, tani do të zëvendësohen me rrethe të eliminimit direkt me nga një ndeshje, ku ndeshjet e rrethit të parë do të luhen në nëntor. Kosovën në këtë garë e përfaqëson FC Prishtina.

Challandes: Muriqi, gola dhe asistime; Rrahmani, modern e besnik

ROMË, 17 SHTATOR - "Muriqi është një përforcim shumë cilësor i Lazios", janë këto fjalët e trajnerit të Kosovës, Bernard Challandes, i cili përshëndet transferimin në Serinë A të sulmuesit "dardan". Në një intervistë për "Radio Kiss Kiss Napoli", 69-vjeçari zbërthen cilësitë tekniko-taktike të shtatlartit të sulmit të Kosovës. "Ka karakteristikat e qendërsulmuesit. Shënon shumë gola dhe jep asistime, di ta bëjë skuadrën të luajë në mënyrën e duhur në fazën sulmuese. Te Lazio ka shumë konkurrencë, por ai do të dijë t'i fitojë hapësirat", ka thënë Challandesi. Challandesi nuk i kurseu fjalët e ëmbla edhe për blerjen e Napolit, Amir Rrahmani.



"Është një futbollist shumë i mirë, një mbrojtës modern. I pastër dhe besnik, i zoti me kokë dhe në mbulimin një për një. Di t'i ndërtojë aksionet nga

poshtë. Mendoj se qoftë me Koulibaly, qoftë me Manolas, do të formojë një dyshe mbrojtëse të një niveli të lartë", ka thënë Challandesi.

Trajneri i Bayernit konfirmon largimin e Thiago

Thiago Alcantara do të largohet nga Bayern Muncheni dhe këtë e ka konfirmuar edhe trajneri Hansi Flick. Mesfushori spanjoll me shumë mundësi do të kalojë në

Premierë Ligë, ku thuhet se ka arritur marrëveshje personale me Liverpoolin. "Thiago është një lojtar fantastik që ka kaluar shtatë sezone mjaft të suksesshme këtu.

Ai është një person i mrekullueshëm dhe një profesionist i vërtetë. Ishte shumë emocionuese kur ai na dha lamtumirën të gjithëve ne sot", ka thënë Flick.

SHKURT

Rashani dëshiron që ta ndihmojë Kosovën ndaj Maqedonisë

Elbasan Rashani është i etur të jetë pjesë e përfaqësueses së Kosovës për ndeshjen e muajit tetor. Ai është i gatshëm të sfidojë një ndalim të mundshëm nga klubi i tij norvegjez Odds. Më 10 tetor në Shkup, Kosova do të përballlet me Maqedoninë e Veriut në plejofin për "Euro 2020". Fituesi do të luajë në finalen e plejofit me fituesin e ndeshjes Gjeorgji - Bjellorusi. "Unë dua të luaj për Kosovën kundër Maqedonisë së Veriut, kështu që ne mund të shkojmë në finale dhe në kampionatin evropian. Klubi duhet ta respektojë dhe të gjejë një zgjidhje për ne që luajmë për ekipet përfaqësuese. Nëse nuk kam zgjidhje, do të largohem. Do të shkoj në atë ndeshje pa marrë parasysh se çka do të ndodhë. Është beteja më e rëndësishme e jetës time", ka thënë Rashani në intervistën dhënë për "Eurosport.no".

Formacioni i vitit në NBA

NBA ka shpallur formacionin ideal të sezonit 2019-2020, duke zbuluar pesë lojtarët më të mirë. Ata janë: LeBron James (Lakers), Giannis Antetokounmpo (Milwaukee Bucks), James Harden (Houston Rockets), Anthony Davis (Lakers) dhe Luka Donçiq (Dallas). LeBron dhe Giannis ishin dy basketbollistët më të votuar, duke marrë secili nga 500 pikë, Harden 474 pikë, Davis 455 dhe Donçiq 416 pikë. Në formacionin rezervë u klasifikuan Kawhi Leonard, Nikola Jokiç, Damian Lillard, Chris Paul dhe Pascal Siakam. Për LeBron James ky është një rekord në NBA, pasi është hera e 16-të që zgjidhet në formacionin më të mirë të sezonit. Ai kaloi në këtë renditje Kareem Abdul-Jabbar, Kobe Bryant e Tim Duncan, me nga 15 përzgjedhje (13 herë përzgjidhet në formacionin e parë).

Hyka prezantohet te Guizhou Hengfeng

Fantazisti 32-vjeçar Jahmir Hyka është zyrtarizuar këtë të mërkurë si blerja e fundit e Guizhou Hengfeng, skuadër që militon në nivelin e dytë më të lartë të futbollit kinez. Hyka konsiderohet nga ky klub futbollist me shumë cilësi dhe përvojë dhe që do të mund të japë një ndihmë të madhe për arritjen e objektivit, që është ngjitja në elitë. Klubi Guizhou Hengfeng i kishte rezervuar një prezantim dinjitoz shqiptarit, që pritet t'i marrë çelësat e mesfushës së kësaj skuadre. Kina është etapa e radhës e futbollistit tiranas, që ka një karrierë të pasur nga Kategoria Superiore, në Greqi, Zvicër, Gjermani, ShBA dhe Izrael.

Vettel: Disa herë kam qenë me një këmbë jashtë Formulës 1

Pas largimit nga Ferrari, piloti gjerman Sebastian Vettel do ta pilotojë makinën Aston Martin. Një transferim i pritshëm, pasi ishte skuadra e vetme ku katër herë kampioni i botës mund të shkonte, aq edhe surprizë, pasi bëhet fjalë për një makinë inferiore krahasuar me Ferrarin. "Nuk ishte një vendim i lehtë. Javët dhe muajt e fundit kanë qenë të vështirë. Madje ju konfirmoj se disa herë kam menduar për t'u tërhequr përfundimisht nga garat. Ishte një situatë që nuk e kisha përjetuar më parë. Mendoj se ky ishte vendimi më i mirë i mundshëm dhe koha do ta vërtetojë. Unë do ta jap maksimumin", ka thënë Vetteli.

Te Aston Martin, Sebastian Vettel do të ketë si shok skuadre Lance Strollin, djalin e pronarit Lawrence Stroll. "Doja të qendroja në Formula 1 nëse do të kishte një projekt tërheqës. Rikthimi i kësaj marke në Formula 1 është i tillë dhe jam krenar që jam pjesë e këtij projekti. Gjithsesi, disa herë kam qenë me një këmbë jashtë Formulës 1", ka deklaruar Vetteli.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “**Ambël**” SH.P.K ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.810180448, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “**Ambël**” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 810180448, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “**Ambël**”, L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 810180448, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Njoftim

Njoftohen të gjithë të interesuarit se me datë 02.10.2020 prej orës 11:00 në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Prishtinës “**Hasan Prishtina**” në amfiteatrin e vogël, kandidati Msc. Nexhat Shkodra, e mban mbrojtjen publike të Punimit të Doktoratës me temën “**EFEKTI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË RRITJEN EKONOMIKE TË VENDEVE TË RAJONIT: RASTI I KOSOVËS**”, me mentor Prof. Dr. Myrvete Badivuku Pantina, para komisionit profesional, në përbërje prej:

1. Prof. Dr. Florentina Xhelili Krasniqi-kryetare.
2. Prof. Ass. Dr. But Dedaj-anëtar.
3. Prof. Dr. Fatmir Memaj-anëtar i jashtëm.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “**Kasneci**”, L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811332444, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “**Kasneci**”, L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811332444, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “**Kasneci**”, L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811332444, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
 OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

GJYKATA THEMELORE
 C.nr.733/2019
 Me dt. 25.08.2020
 Mitrovicë

PRISHTINË

Ne bazë të nenit 83 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të Kosovës kërkojmë të publikoni këtë,

SH P A L L J E

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, në qështjen juridike të paditësit Xhevat Veseli nga Mitrovica kundër të paditurit Muse Gashi ish nga Mitrovica, tani me vendbanim te panjohur, ne baze te nenit 79 pika 3-a e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore te Kosoves te paditurit Muse Gashi i caktohet perfaqesuesi i perkoheshem – Avokate **Shkeleqesa Musa** nga Mitrovica.

Përfaqësuesi i përkohshme do ta përfaqësoj të paditurin në këtë çështje juridike deri sa ai apo i autorizuari i tij të paraqitet në këtë gjykatë.

GJYQTARI
 Ragip Kadriu



KOMUNA SHTRËPCË
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Bazuar në Ligjin për Arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, neni 35; Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Ligjin e Punës nr.03/L-212, Udhëzimin Administrativ të MASHT-it, nr.15/2019, të datës: 19.07.2019,
Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

KONKURS

Nr. Prot.08-030/01-9767/20

Titulli i vendit të punës:

Drejtore në shfmu. "Razim Cokli" në Brod

Koeficient: 7.8

Orët në javë: 40

Kontrata: 4 vjet

Drejtore në shfmu. "Anton Santori" në Bitijë

Koeficient: 7.8

Orët në javë:40 (... plotësohet me 10 orë mësimdhënie)

Kontrata: 4 vjet

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Drejtori i institucionit edukativo-arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:

- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlidhura të praktikës, sigurimin dhe përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë tërë vitit shkollor.
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin e mësimdhënësve, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- Mbështetjen dhe mbikqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikqyrjen e punës së aktiveve profesionale dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor
- Bashkëpunon me Këshillin drejtues të Shkollës (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor.
- Raporton dy herë në vit para KDSH
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve.
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT);
- Qështjet e tjera që rregullohen përmes këtij ligji dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim;
- Vlerësimi i performancës së drejtorëve do të bëhet me Udhëzimin administrativ (UA) përkatës bazuar në standardet e praktikës profesionale të drejtorëve.

Kushtet:

Kandidatët e interesuar për të konkurruar për vendin e drejtorit, duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës.
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit:
- Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 330 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar)
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar)
- Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar)
- Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar)

Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve;

- Të kenë përfundur me sukses një program kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim të aprovuar nga MASHT, sipas rekomandimit të KSHLM.
- Të kenë përvojë pune në procesin edukativ-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
- Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativ-arsimor për kandidatët për arsimin e mësimdhënësve të lartë.
- Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativ-arsimor për kandidatët në nivelet tjera dhe
- Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativ-arsimor për kandidatët për zëvendësdrejtor.

Të posedoj këto dokumente:

Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;

- Në arsimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët të mesëm të lartë (gjimnaze), kandidati/ja duhet të jetë i profilit arsimor, në bazë të normativit profesional për arsim të përgjithshëm.
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore.
- Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krime, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët.
- Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor.
- Konceptin e Planit Zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor për të cilin ka konkurruar. Koncepti duhet të bazohet në fushat e cilësisë në arsim dhe të ketë 5-10 faqe tekst (një faqe për një fushë) me hapësirë 1.5. fontit i shkronjave 12, arial). Koncepti dorëzohet si pjesë e portfolios, por është edhe pjesë përbërëse kryesore e intervistës;
- Letër reference me përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake nga një institucion publik-kredibil (si Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli drejtues i institucionit edukativo-arsimor, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë dhe individë me të cilët ka punuar ngushtë në programe të ndryshme për arsim)
- Letër motivuese për vendin e punës për të cilin aplikon;
- Portfolion profesionale.
- Kandidati/ja për drejtor, nuk mund të jetë në funksion udhëheqës politik gjatë tri viteve para aplikimit.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.

Aplikacionet mirren dhe dorëzohen (të kompletuara) në Komunë, zyra nr. 28



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO



OPSTINA STRPCE
KOMUNA SHTRËPCË
MUNICIPALITY OF STRPCE

Komuna Shtërpçë

Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Bazuar në Ligjin e Punës nr.03/L-212 neni 8; Ligjin për Arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, neni 35 paragrafi 1, 4 dhe 5; Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, neni 5 pika c; Udhëzimi Administrativ (MPMS) 07/2017; Udhëzimin Administrativ 10/2018 (MASHT) Normativ për Kuadrin e Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

KONKURS

SHFMU. "Razim Cokli" Brod

Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës/e klase

Koeficient: A-421/1

Numri i referencës: 08-030/01-9770/20

Përshkrimi i vendit të punës:

DETYRAT KRYESORE:

Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies. Të përgatis me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditore në përputhje me Kurrikulën e në pajtim me kërkesat për përshtatjen e mësimdhënies aftësive dhe prirjeve individuale të çdo nxënësi.

Të ketë njohuri për një repertuar të gjërë të stileve mësimore dhe të jetë në gjendje t'i aplikoj ato që më së miri i përgjigjen situatës në klasë. Të shfrytëzojë në mënyrë efektive resurset që i ka në dispozicion. Të planifikoj, të udhëheqë dhe të vëzhgojë nxënësin dhe sjelljen e secilit nxënësi.

Të zbatoj metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare. Të krijoj një atmosferë pune dhe discipline, pa përdorur metoda ndëshkimi ose forma të ndryshme të poshtërimit ndaj nxënësve. Të kontrolloj me rregull dhe të mbaj evidencë për suksesin dhe progresin individual të secilit nxënësi si dhe të jetë në gjendje t'i raportoj prindit apo kujdestarit të fëmijës drejt për progresin e arritur të nxënësit sipas kërkesës.

Të zgjoj te nxënësit kureshtjen për të nxënë dhe t'i inkurajoj ata të nxënë në mënyrë të pavarur.

Të kujdeset për zhvillim të vazhdueshëm profesional individual sipas planit të paraparë dhe të kujdeset për realizimin e planifikimit.

Të jetë në komunikim të vazhdueshëm me familjen e çdo nxënësi duke realizuar takime individuale me prindër/ kujdestarë të fëmijës.

Të ndihmojë kolegët për ngritjen e cilësisë së punës.

Të mbikqyrë dhe të udhëzojë nxënësit në procesin mësimor.

Të marrë pjesë në punën e organeve të shkollës.

Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe evenimenteve në shkollë, kur kërkohet nga drejtori i shkollës.

Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtëmësimore me nxënësi dhe kryej me përgjegjësi ekskursionet me nxënësi brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve të drejtorit të shkollës.

Të tregoj respekt, sjellje kolegjiale dhe jodiskriminuese ndaj bashkëpunëtorëve me të cilët punon.

Të mbajë orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.

I punësuar është i obliguar të respektoj kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar në rregullorën e brendshme të shkollës.

Kushtet e konkursit:

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional, sipas UA. 10/2018 (MASHT):

- Diploma
- Certifikata e lindjes
- Letërnjoftimi
- Vërtetim nga gjykata

Kohëzgjatja e kontratës fillon prej datës së fillimit të punës deri më 31.08.2021

Fletëaplikacionet mirren në DKA ose në shkollë dhe dorëzohen (me dëshmi të verifikuara të kualifikimeve) në objektin e Komunës së Shtërpçës, zyra nr. 28

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit zyrtar (tabela e shpalljeve, webfaqen e komunës, gazetë ditore), duke filluar nga data 18.09.2020 deri më 02.10.2020



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



DREJTORIA E ARSIMIT
05nr.1462 datë:16.09.2020

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, UA.MASHT-nr.26/2013, UA.MASHT-nr.34/2014 Funksionalizimi i shërbimit profesional pedagogjik-psikologjik, Udhëzimit administrativ(MPMS) nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall:

KONKURS Për plotësimin e vendeve të lira të punës

1.SHFMU "Naum Veqilharxhi" në Mohlan

Vendi i punës:Psikolog/e - Pedagog/e shkolle me plotësim norme në SHFMU "Lidhja e Prizrenit" në Budakovë, SHFMU "Sadri Duhla" në Duhël, SHFMU "Ismet Jashari-Kumanova" në Javorë dhe SHFMU " Besim Ndrecaj" në Maqitevë

Paga Mujore :Koefficienti 6
Periudha provuese: Gjashtë muaj

2.SHFMU "Dëshmorët e Tivarit" në Peqan

Vendi i punës:Psikolog/e - Pedagog/e shkolle me plotësim norme në SHFMU "Bajram Curri" në Nishor, SHFMU "Hasan Prishtina" në Smetisht, SHFMU "Xhavit Sylaj" në Sllapuzhan, SHFMU "Flamuri i Arbrit" në Reshtan dhe SHFMU "28 Nëntori" në Doberdelan

Paga mujore: Koefficienti 6
Periudha provuese: Gjashtë muaj

3.SHFMU "Shkëndija" në Suharekë

Vendi i punës:Psikolog/e - Pedagog/e shkolle me plotësim norme në SHFMU "Ramë Bllaca" në Bllacë dhe SHFMU "17 Shkurti" në Shirokë.

Paga Mujore: Koefficienti 6
Periudha provuese: Gjashtë muaj

4.SHFMU "Dëshmorët e Greikocit" në Greikoc

Vendi i punës:Psikolog/e - Pedagog/e shkolle me plotësim norme në SHFMU "Shaban Mazreku" në Sopiçë, SHFMU "Gj.K. Skenderbeu" në Sallagrazhdë, SHFMU "Migjeni" në Gjinc dhe SHFMU "Drita" në Gelancë.

Paga Mujore: Koefficienti 6
Periudha provuese: Gjashtë muaj

Detyrat kryesore të punës për psikolog:

Të vlerësoj dhe interpretoj çështjet që kanë të bëjnë me procesin e të nxënës dhe zhvillimin psikologjik, social, dhe emocional të nxënësve;

- ✓ Të ofroj ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë;
- ✓ Të ofroj ndihmë në identifikimin e nxënësve me vështirësi në të nxënë dhe nxënësve të talentuar;
- ✓ Të zhvilloj intervista me nxënës, mësimdhënës e prindër, vëzhgime e procedura të ndryshme, me qëllim të vlerësimit objektiv, dhe propozon e zbaton masa për intervenime psiko-edukative individuale në grupe,
- ✓ Të mbajë lidhje me arsimtarët lidhur me nxënës të cilët kanë nevojë për ndihmë ose kanë probleme personale,
- ✓ T'i këshilloj nxënësit, të cilët kanë nevojë për ndihmë në mësim, punë vazhduese, këshilloj për zgjidhjen e profesionit ose të cilët kanë nevojë për këshilla për të tejkaluar problemet personale;
- ✓ Të përgadit raporte mujore dhe vjetore për drejtorin e shkollës
- ✓ Të angazhohet në dy e më tepër shkolla, sipas nevojës (aty ku numri i nxënësve është më i vogël)
- ✓ Të angazhohet në komisionet profesionale;
- ✓ Të kryej dhe detyra tjera të caktuara nga drejtori dhe ato të përcaktuara me akte normative .

Kualifikimi : Fakulteti Filozofik-drejtimi psikologjise sipas UA. MASHT nr. 34/2014

5. SHFMU "Naum Veqilharxhi" në Mohlan me plotësim norme në SHFMU "Lidhja e Prizrenit" në Budakovë dhe SHFMU "Besim Ndrecaj" në Maqitevë.

Vendi i punës: zyrtar/e administrativ(sekretar)

Paga mujore: Koefficienti 6.3

Kohëzgjatja e kontratës : Për periudhë të pacaktuar, me orar të plotë
Periudha provuese : Gjashtë muaj

6. SHFMU "Dëshmorët e Tivarit" në Peqan me plotësim norme në SHFMU "Xhavit Sylaj" në Sllapuzhan dhe SHFMU "Ismet Jashari-Kumanova" në Javor.

Vendi i punës: zyrtar/e administrativ(sekretar)

Paga mujore: Koefficienti 6.3

Kohëzgjatja e kontratës : Për periudhë të pacaktuar, me orar të plotë
Periudha provuese : Gjashtë muaj

7. SHFMU "Hasan Prishtina" në Smetisht me plotësim norme në SHFMU "Bajram Curri" në Nishor dhe SHFMU "Drita" në Gelancë.

Vendi i punës: zyrtar/e administrativ(sekretar)

Paga mujore: Koefficienti 6.3

Kohëzgjatja e kontratës : Për periudhë të pacaktuar, me orar të plotë
Periudha provuese : Gjashtë muaj

8. SHFMU "V. P. Shkodrani" në Leshan me plotësim norme në SHFMU "28 Nëntori" në Doberdelan.

Vendi i punës: zyrtar/e administrativ(sekretar)

Paga mujore: Koefficienti 6.3

Kohëzgjatja e kontratës : Për periudhë të pacaktuar, me orar të plotë
Periudha provuese : Gjashtë muaj

9. SHFMU "Kongresi i Manastirit" në Studenqan me plotësim norme në SHFMU "Rilindja" në Njëpërbisht.

Vendi i punës: zyrtar/e administrativ(sekretar)

Paga mujore: Koefficienti 6.3

Kohëzgjatja e kontratës: Për periudhë të caktuar (deri në përfundimin e manaditit të drejtorit të shkollës), me orar të plotë

Periudha provuese: Gjashtë muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- ✓ Kujdeset për zbatimin e dispozitivave dhe akteve tjera juridike ne institucioni arsimor,
- ✓ Ndhmon drejtorin e shkollës lidhur me organizimin dhe administrimin e aktiviteteve në shkollë,
- ✓ Shkruan shkresa, vendime dhe akte tjera të rëndësishme për shkollën,
- ✓ Udhëheq punët administrative, financiare dhe teknike në institucionet shkollore,
- ✓ Kujdeset për arkivin e shkollës, sistemimin e dosjeve të punëtorëve, kontratat e punës, librin e regjistrimit të punëtorëve,
- ✓ Përgatit ndryshimet mujore sipas nevojës për listen e pages për punëtorët .
- ✓ Kryen dhe detyra të tjera të cilat ia cakton drejtori i shkollës.

Kualifikimi : Fakulteti Juridik ose Ekonomik

Dokumentacioni i nevojshem për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Diplomat e shkollës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje) e vërtetuara tek noteri.
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmia e përvojës së punës (nëse ka)
- Certifikata që nuk jeni nën hetime

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara të vërtetuara nga noteri, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës. Afati i konkurimit 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë.

Për orarin e testimit me shkrim dhe intervistimit me gojë do të informoheni në faqen zyrtare të Komunes së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

► Vlera Krasniqi shpall të humbur dëftesat e shkollës "Isa Boletini" për klasën e VI,VII, VIII, IX

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS MUNICIPALITY SUHAREKË OPSTINE SUVA REKA	
---	---	---

DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE
05nr .1462 datum: 16.09.2020

Na osnovu člana 8. Zakona o radu br. 03 / L-212, člana 35. Zakona o pred-univerzitetskom obrazovanju u Republici Kosova sa br. 04 / L-032, član 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosova br. 03 / L-068, AU.MONT-a -br.26 / 2013, AU MONT-a -br.34 / 2014 Funkcionalizacija profesionalne pedagoško-psihološke službe nastavnika u školama, Administrativno uputstvo (MRSZ) br.07 / 2017 o regulisanju postupaka za zasnivanje radnog odnosa u javnom sektoru, Opštinska direkcija za obrazovanje objavljuje:

KONKURS
Za popunu slobodnih radnih mesta

- ONSS "Naum Veqilharxhi" u selu Movljane**
Radno mesto: Psiholog škole sa dopunom norme ONSS "Lidhja e Prizrenit" u Budakovu, ONSS "Sadri Duhla" u Dulje, ONSS "Ismet Jashari-Kumanova" u Javoru i ONSS "Besim Ndrecaj" u Maqitevo
Mesečna plata: Koeficijent 6
Probni rad: šest meseci
- ONSS "Deshmoret e Tivarit" u Peqanu**
Radno mesto: Psiholog škole sa dopunskom normom u ONSS "Bajram Curri" u Nišoru,
ONSS "Hasan Prishtina" u Semetište, ONSS "Xhavit Sylaj" u Sllapuzane,
ONSS "Flamuri i Arbrit" u Reštane i ONSS "28 Nentori" u Doberdeljane
Mesečna plata: Koeficijenti 6
Probni rad: šest meseci
- ONSS "Shkendija" u Suvoj Reci**
Radno mesto: Psiholog škole sa dopunskom normom u ONSS "Rame Blaca" u Blace i ONSS "17 Shkurti" u Široko
Mesečna plata: Koeficijenti 6
Probni rad: šest meseci
- ONSS "Deshmoret e Grejkocit" u Greikovce**
Radno mesto: Psiholog škole sa dopunskom normom u ONSS "Shaban Mazreku" u Sopino, ONSS "G.J.K. Skenderbeu" u Sallagrazde, ONSS "Migjeni" u Đinovce i ONSS "Drita" u Geljance.
Mesečna plata: Koeficijenti 6
Probni rad: šest meseci
Glavne dužnosti psihologa:
Proceniti i protumačiti pitanja u vezi sa procesom učenja i psihološkim, socijalnim i emocionalnim razvojem učenika;
Pružanje pomoći u prevazilaženju poteškoća psihološke prirode sa svim akterima u školi;
Pružiti pomoć u identifikovanju učenika sa poteškoćama u učenju i talentovanih učenika;
Da obavi intervju sa učenicima, nastavnicima i roditeljima, razna zapažanja i postupke, u cilju objektivne evaluacije, i predlaže i sprovodi mere za pojedinačne psiho-vaspitne intervencije u grupama,
Da bude u kontaktu sa nastavnicima o učenicima kojima je potrebna pomoć ili imaju ličnih problema,
Da savetuje učenike kojima je potrebna pomoć u učenju, nastavku rada, savetovanje o izboru karijere ili kojima je potreban savet za prevazilaženje ličnih problema;
Da priprema mesečne i godišnje izveštaje za direktora škole
Po potrebi se angažuje u dve ili više škola (gde je broj učenika manji)
Angažovanje u profesionalnim komisijama;
Da izvršava druge zadatke koje mu je dodelio direktor i one definisane normativnim aktima.
Kvalifikacija: Filozofski fakultet-smer psihologija prema AU. MONT-a br. 34/2014
- ONSS "Naum Veqilharxhi" u Movljane sa dopunskom normom u ONSS "Lidhja e Prizrenit" u Budakovu i ONSS "Besim Ndrecaj" u Maqitevo.**
Radno mesto: administrativni službenik/ca (sekretar)
Mesečna plata: Koeficijenti 6.3
Trajanje ugovora: Na neodređeno vreme, puno radno vreme
Probni rad: šest meseci
- ONSS "Deshmoret e Tivarit" u Pečane sa dopunskom normom u ONSS "Xhavit Sylaj" u Sllapuzane i ONSS "Ismet Jashari-Kumanova" u Javoru.**
Radno mesto: administrativni službenik/ca (sekretar)
Mesečna plata: Koeficijenti 6.3
Trajanje ugovora: Na neodređeno vreme, puno radno vreme
Probni rad: šest meseci
- ONSS "Hasan Prishtina" u Semetište sa dopunskom normom u ONSS "Bajram Curri" u Nišoru i ONSS "Drita" u Geljance.**
Radno mesto: administrativni službenik/ca (sekretar)
Mesečna plata: Koeficijenti 6.3
Trajanje ugovora: Na neodređeno vreme, puno radno vreme
Probni rad: šest meseci
- ONSS "V. P. Shkodrani" u Lešane sa dopunskom normom u ONSS "28 Nentori" u Doberdeljane.**
Radno mesto: administrativni službenik/ca (sekretar) Mesečna plata: Koeficijenti 6.3
Trajanje ugovora: Na neodređeno vreme, puno radno vreme
Probni rad: šest meseci
- ONSS "Kongresi i Manastirit" u Studenčane sa dopunskom normom u ONSS "Rilindja" u Neprobište.**
Radno mesto: administrativni službenik/ca (sekretar)
Mesečna plata: Koeficijenti 6.3
Trajanje ugovora: Na određeno vreme (do kraja mandata direktora škole), puno radno vreme
Probni rad: šest meseci
Dužnosti i odgovornosti:
- Stara se o sprovođenju odredbi i drugih pravnih akata u obrazovnoj ustanovi,
- Pomaže direktoru škole u organizovanju i administraciji školskih aktivnosti
- Piše radove, odluke i druge važne akte za školu,
- Rukovodi administrativnim, finansijskim i tehničkim poslovima u školskim ustanovama,
- Stara se o školskoj arhivi, sistematizaciji dosijea zaposlenih, ugovorima o radu, matičnoj knjizi zaposlenih,
- Priprema mesečne promene po potrebi za obračun zarada zaposlenih.
- Obavlja ostale zadatke koje mu dodeli direktor škole.
Kvalifikacija: Pravni ili Ekonomski fakultet
Neophodna dokumentacija za konkurs:
• Obrazac prijave (zahtev) koji popunjava kandidat
• Diploma o kvalifikacionom stepenu ili uverenje umesto diplome koja ne bi trebalo da bude starija od šest meseci (fotokopija) overena kod notara.
• Izvod rođenja
• Lična karta (fotokopija)
• Dokaz o radnom iskustvu (ako postoji)
• Potvrda da niste pod istragom
Kompletna dokumentacija se predaje fotokopirana i overena kod notara, dok će se originalna dokumentacija predstavljati na uvid na intervjuu. Nepotpuna dokumenta i ona koja stignu nakon isteka roka komisija neće razmatrati. Prijave se primaju i predaju u prijemnoj kancelariji u Opštini Suva Reka. Konkurs ostaje otvoren 15 (petnaest) dana od dana objavljivanja u novinama.
Bićete obavešteni o rasporedu pismenog testa i usmenog intervju na zvaničnoj veb stranici opštine Suva Reka i na oglasnoj tabli ODO.

Direktor ODO
Renzi Bajselmani



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Joliar" Sh.p.k Potreq, Klinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit në Pjetërq i Poshtëm, Klinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.10.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Arfa Oil" në Pjetërq i Poshtëm, Klinë do të organizohet debat publik nga kompania "Joliar" Sh.p.k Potreq, Klinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit në Pjetërq i Poshtëm, Klinë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

[https://us04web.zoom.us/j/4549344495?](https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=NjkzeHFBUzJGZEc4dXUzeGx2NXVtZz09)
[pwd=NjkzeHFBUzJGZEc4dXUzeGx2NXVtZz09](https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=NjkzeHFBUzJGZEc4dXUzeGx2NXVtZz09)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" FAKULTETI JURIDIK

Në pajtim me nenin 127 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, nenin 17.4 të Rregullores për Studimet e Doktoratës, si dhe Vendimin (nr. 1/355) të Senatit të Universitetit të Prishtinës, Zyra për Shërbime Postdiplomike e Fakultetit Juridik, shpallë këtë:

NJOFTIM

Me të cilin njoftohen të interesuarit se me datën 28.09.2020, në orën 13:00 në hapësirat e Fakultetit Juridik do të organizojë mbrojtjen publike të Disertacionit të Doktoratës të kandidatit Ma.sc. Arbnor Ajeti, me titull: "Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën kontestimore" me Mentor: Prof. Asoc. Dr. Rrustem Qehaja, para Komisionit Vlerësues në përbërje:
Prof. Dr. Iset Morina (Kryetar);
Prof. Asoc. Dr. Haxhi Gashi (Anëtar);
Prof. Dr. Mariana Semini (Anëtare).

Ky njoftim rishpallet pasi që njoftimi i shpallur me datë 10.07.2020 në gazetën Epoka e Re për organizimin e kësaj mbrojtje në hapësirat e Fakultetit Juridik me datë 20.07.2020, nuk është organizuar mbrojtja me datën e paralajmëruar për arsye të situatës së rënduar me Covid-19. Andaj, pasi që janë krijuar kushtet për organizimin e mbrojtjes së disertacionit të doktoratës të kandidatit Ma. sc. Arbnor Ajeti, rishpallet njoftimi si me lartë.

Prishtinë, 17.09.2020
Suzana Gusija
Zyrtare për Shërbimin e Studimeve të Doktoratës
Fakulteti Juridik



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

